

RAPORTI

► FAQE 4-5

JA "PROVAT" E TEKNIKEVE PER DEFORMIMIN E ZGJEDHJEVE

Ministrat e PD-së zyrtarizuan dje largimin nga qeveria duke dorëzuar raportin për zgjedhjet. 6 mbledhje Task-Force, vetëm me teknikët



EKSKLUZIVE

Knut Fleckenstein rrëzon raportin e ministrave të PD-së

"Duhet të presim që Raporti i OSBE-së të vlerësojë nëse është bërë gjithçka e mundur për të garantuar lirinë e votave"

► FAQE 6

KLAUDJA KARABOLLI

[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VII - NR. 194

E PREMTE, 18-08-2017

www.shqiptarja.com

PASURITE E GJYQESORIT

GJYQTARI ME TERREN SPORTIV, LOKAL DHE 450 MIJE USD

Zbardhen pasuritë e disa gjyqtarëve të shkallës së parë dhe Apelit. Çuditë e drejtësisë, bashkëjetuesja e gjyqtarit që bën 7 punë njëherësh, fitoi 230 mijë USD brenda vitit. Një gjyqtar deklaroi se nuk e dinte se kishte një apartament që prej 13 vitesh. Gjyqtarët kredi qindra mijëra euro

ADRIATIK DOÇI

► FAQE 2-3



Buxheti i shtetit

Akti Normativ, ja si ndryshojnë zërat e buxhetit 2017

Si do të përballohet rritja e pagave, investimet, arbitrazhet dhe pagesa e papunësisë

► FAQE 12-13



VENDIMI I DJESHËM

Gjykata kroate: Ballist Morina të ekstradohet në Serbi

I vëllai: Kemi dy shpresa, apelojmë vendimin. Avokati: Beteja ligjore vazhdon

► FAQE 16

Liqeni i Shkodrës

HYJNE TE LAHEN NE LIQEN, MBYTEN DY KUSHERINJ

Viktimat 13 vjeç dhe 15 vjeç, të dy banues në fshatin Gruemirë

► FAQE 14



DOSSIER/ ERNEST JAKOVA:

"PSE NUK MUND TE KETE KURRE REHABILITIM PER ENVER HOXHEN"

Pjesa e fundit e analizës së gjeneral-majorit. "Ai nuk është dënuar asnjëherë dhe për asgjë"

► FAQE 18-19



GODET TERRORIZMI

Furgoni mbi turmën në Barcelonë, 13 viktima

Kapen 2 nga autorët, një tjetër vritet. Deri më tani 80 persona të plagosur

► FAQE 20

Gjyqtari me terren sportiv, lokal dhe 450 mijë USD

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Gjyqtarët që shërbejnë në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, në Tiranë apo në rrethe, ashtu si anëtarët e organeve më të larta të drejtësisë, posedojnë pasuri befasuese në raport me pagat e tyre dhe nivelin e jetesës në Shqipëri. Disa gjyqtarë thonë se nuk e kanë ditur se kishin edhe një apartament tjetër në bashkëpronësi, ndërsa dikush tjetër deklaroi se bashkëjetuesja e tij bën 7 punë njëherësh. Shqiptarja.com u referohet vetëm deklaratave të pasurisë për vitin 2016 dhe jo deklaratave fillestare apo deklaratave të viteve të ndërmjetëm, çka do të thotë se, pasuria e pasqyruar është vetëm një pjesë e pasurisë reale që posedojnë gjyqtarët.

ARTAN GJERMENI

Gjatë vitit 2016, gjyqtari i Gjykatës së Tiranës, Artan Gjermeni, deklaroi katër pasuri të reja të paluajtshme, konkretisht terren sportiv, lokal, tokë bujqësore dhe shtëpi banimi. Gjyqtari deklaroi një shtëpi banimi në Lushnjë, me sipërfaqe 74 m², me dëshmi trashëgimie, 66.6% të pjesës. Gjermeni është gjithashtu pronar në masën 100% i një toke bujqësore, me sipërfaqe 1 856 m², në fshatin Kutje të Lushnjes, përfutur me dëshmi trashëgimie. Ai deklaroi se posedon 20% të një terreni sportiv, me sipërfaqe 1 092 m², i mbuluar dhe me dhoma zhveshje. Po gjatë vitit 2016, gjyqtari është bërë bashkëpronar në masën 20% i një tjetër pasurie të paluajtshme, ku përfshihen truall me sipërfaqe 450 m² dhe ndërtesë, bar kafe,

Artan Gjermeni

Gjatë vitit 2016, gjyqtari i Gjykatës së Tiranës, Artan Gjermeni, deklaroi katër pasuri të reja të paluajtshme, konkretisht terren sportiv, lokal, tokë bujqësore dhe shtëpi banimi.



Çudia

Alma Osmanaj, bashkëjetuesja e gjyqtarit të Gjykatës së Tiranës, Bledar Abdallai, rezultoi me të ardhura nga shatë punë të ndryshme, brenda dhe jashtë vitit, në sektorin provat dhe publik. Të ardhurat brenda vitit janë rreth 240 mijë USD.



1 kat me sipërfaqe 90 m². Në deklaratën e pasurisë nuk të dhëna për vendndodhjen e terrenit sportiv dhe lokalit. Gjyqtari ka

gjithashtu në pronësi një dyqan me sipërfaqe 40 m², në Tiranë, të cilin e ka dhënë me qira si dhe një zyrë në qytetin e Lushnjes, dhënë gjithashtu me qira. Artan Gjermeni deklaroi rreth 370 mijë USD depozita dhe llogari bankare, konkretisht depozitë në vlerën 18 586 203 lekë, depozitë të bashkëshortes, në vlerën 16 537 246 lekë, llogari bankare, shtuar me 3 489 181 lekë në 2016, llogaria e rrjedhëse 1 049 272 lekë etj. Duke përfshirë pagat, të ardhurat nga qiratë, shtesat dhe gjendjet në llogari dhe depozita bankare, shuma arrin mbi 450 mijë USD.

ÇUDITË E DREJTËSISË

Gjyqtarja e Gjykatës së Tiranës, Anila Capo, deklaroi një overdraft në Bankën Credins, me një vlerë të pazakontë, 1 700 000 lekë. Bashkë me bashkëshortin zonja ka marrë edhe 300 mijë euro kredi në Bankën Amerikane të Investimeve. Ata kanë marrë edhe një kredi në Bankën Credins, 130 mijë euro si dhe një huamarrje personale 13 mijë euro. Bashkëshorti i gjyqtarës, Sejdin Zere, rezultoi administrator i pesë kompanive, ku deklaroi 1 967 424 lekë pagën dhe 3 875 081 lekë fitime. Kurse, Ken Dhima, gjyqtar pranë



Gjykatës Administrative në Vlorë, deklaroi një apartament banimi me sipërfaqe 51,65 m², sipas vërtetimit të dokumentit hipotekor datë 01.03.2014, për të cilin gjyqtari thotë se nuk e ka ditur se kishte 1/5 e pasurisë. Në mars të vitit 2014, ILDKP e kallëzoi penalisht Ken Dhimën për deklarim të rremë, fshehtë të pasurive dhe për mosmbulim të vlerës së krijimit të aseteve dhe shpenzimeve me burime të ligjshme për vitet 2005, 2007 dhe 2008.

BASHKËJETUESJA QË BËN 7 PUNË

Alma Osmanaj, bashkëjetuesja e gjyqtarit të Gjykatës së Tiranës, Bledar Abdallai, rezultoi me të ardhura nga shatë punë të ndryshme, brenda dhe jashtë vitit, në sektorin provat dhe publik. Për vitin 2016, ajo deklaroi 13 049 443 lekë ose rreth 100 mijë euro të ardhura si notere në Tiranë, 3 047 836 lekë të ardhura nga paga në Ministrinë e Drejtësisë, 94 237 lekë të ardhura nga paga si ju-


riste pranë QSUT, 17 100 lekë të ardhura si pedagoge pranë 'Albanian University', 73 mijë USD të ardhura nga punësimi jashtë vendit, 1 350 euro të ardhura nga punësimi pranë Projektit të Grupit të Krizave Ndërkombëtare dhe 3 mijë euro të ardhura nga shërbimi lidhur me ReSPA, financim nga BE. Mbetet e paqartë se si zonja në fjalë ka punuar njëherësh në dy institucione publike siç është QSUT dhe Ministria e Drejtësisë. Gjithashtu duket e habitshme se

Pasuritë e disa gjyqtarëve të shkallës së parë dhe apelit

ARTAN GJERMENI GJYKATA E TIRANËS (2016)
Shtëpi banimi në Lushnjë, 74 m ² , me dëshmi trashëgimie, 66.6% të pjesës.
Tokë bujqësore me sipërfaqe 1 856 m ² , në fshatin Kutje të Lushnjes, me dëshmi trashëgimie, 100% të pjesës.
Truall dhe ndërtesë, terren sportiv, i mbuluar dhe me dhoma zhveshje, me sipërfaqe 1 092 m ² , (1 kat 56 m ²), fituar me dëshmi trashëgimie, 20% të pjesës.
Truall me sipërfaqe 450 m ² dhe ndërtesë, bar kafe, 1 kat me 90 m ² , fituar me trashëgimi në 2016, 20% të pjesës.
Të ardhura nga qira e dyqanit në Tiranë, me sipërfaqe 40 m ² , 120 000 lekë.
Të ardhura nga qiraja e zyrës në Lushnjë, 210 000 lekë.
Llogari bankare, shtuar në 2016 me 3 489 181 lekë.
Depozitë bankare në Raiffesien Bank, vlerën 18 586 203 lekë
Depozitë bankare në Raiffesien Bank e bashkëshortes, 16 537 246
Llogaria e rrjedhëse e pagës dhe shpërblimeve në Credins Bank, 1 049 272 lekë.
Kartë krediti me limit, 50 000 lekë.
Llogari e rrjedhëse në emër të djalit, 4 438 dhe 13 138 lekë.
Llogari e rrjedhëse e bashkëshortes si notere, 319 188 lekë.
Të ardhura nga paga, 1 372 511 lekë.
Të ardhura nga paga e bashkëshortes si notere, 5 111 297 lekë.
Të ardhura nga paga e djalit si këshilltar ligjor pranë... 234 432 lekë.

BLENDAR ABDALLAI GJYKATA E TIRANËS
Paga si gjyqtar, 1 136 590 lekë.
Pjesëmarrje në mbledhjet e Komisionit të Apelit të FSHF, 51 000 lekë.
Bashkëjetuesja, Alma Osmanaj, apartament në Tiranë, me sipërfaqe 118 m ² , 7 758 900 lekë.
Garazh në Tiranë, me sipërfaqe 20 m ² , 14 500 euro,
Makinë tip Toyota, 1 400 000 lekë.
Apartment me sipërfaqe 98 m ² , në Golem, 50 mijë euro.
Llogari kursimi, 65 092 lekë.
Llogari kursimi, 3 451 USD.
Llogari kursimi, 1 001 euro.
Të ardhura si notere në Tiranë, 13 049 443 lekë.
Të ardhura nga paga në Ministrinë e Drejtësisë, 3 047 836 lekë.
Të ardhura nga paga si juriste pranë QSUT, 94 237 lekë.
Të ardhura si pedagoge pranë 'Albanian University', 17 100 lekë.
Të ardhura nga punësimi jashtë vendit, 73 845 USD.
Të ardhura nga punësimi pranë Projektit të Grupit të Krizave Ndërkombëtare, 1 350 euro.
Të ardhura nga qira, 3 600 euro.
Të ardhura nga shërbimi lidhur me ReSPA, financim nga BE, 3 mijë euro.

ANILA CAPO GJYKATA E TIRANËS (2016)
Overdraft në Bankën Credins, 1 700 000 lekë.
Hua në Bankën Amerikane të Investimeve, 300 mijë euro.
Paga si gjyqtare, 1 383 660 lekë.
Llogari bankare, 94 757 lekë.
Llogari bankare, 55,92 GBP.
Llogari bankare, 814 lekë.
Llogari bankare, 1 160 lekë.
Llogari bankare, 1 704 lekë, minus 2 348 euro, 8 209 lekë, 2 997 lekë.
Bashkëshorti, Sejdin Zere, paga si administrator i pesë kompanive, 1 967 424 lekë.
Fitimi nga aktiviteti i 5 kompanive, 3 875 081 lekë.
Të ardhura nga kontrata e qerasë me shoqërinë..., 20 400 euro.
Pagesë e shpronësimit në favor të S. Zere, 34 200 000 lekë.
Kredi personale në Bankën Credins, 130 mijë euro, detyrimi i mbetur 125 962 lekë.
Huamarrje personale 13 mijë euro, detyrimi i mbetur 6 500 euro.
ALKELENA GAZIDEDJA GJYKATA E TIRANËS (2016)
Interesa nga depozita në emër të bashkëshortit, 72 380 lekë.
Hapje depozite në emër të bashkëshortit, 1 000 000 lekë.
Mbyllje llogarie në emër të bashkëshortit, 381 lekë.



si ajo ka punuar njëherësh në QSUT, Ministrinë e Drejtësisë, jashtë vendit, si notere në Tiranë etj. Ndërkaq, Alma Osmanaj deklaron apartament në Tiranë, me sipërfaqe 118 m2, me vlerë 7 758 900 lekë, garazh në Tiranë me vlerë 14 500 euro, makinë tip Toyota me vlerë 1 400 000 lekë dhe apartament në Golem me vlerë 50 mijë euro.

SHITBLERJET E PASURIVE

Ilir Çeliku, ish-gjyqtar i Apelit në Vlorë, deklaroi se gjatë

vitit 2016, ka shitur pasuri të paluhatshme në Tiranë, në vlerën 250 mijë euro. Gjyqtarja Aantoneta Prendi ka shitur një pasuri të paluhatshme të paspecifikuar, për të blerë një apartament në Tiranë, me sipërfaqe 86 m2, me vlerë 69 690 euro. Ndërsa Enkeleda Kapedani, gjyqtaren në Gjykatën e Elbasanit ka shitur tokë arë në Golem, me vlerë 1 400 000 lekë. Gjyqtarja e Beratit thotë se ka marrë një hua pa afat për blerjen e një apartamenti.

Hapje dhe mbyllje fond investimi, 837 000 lekë.
Interesa nga depozita në emër të bashkëshortit, 3 106 lekë.
Gjendje cash në shtëpi, 1 400 000 lekë.
Gjendje lekë në bankën Raiffeisen Bank, 717 510 lekë.
Llogari biznesi në emër të bashkëshortit, 500 000 lekë.
Interesa nga depozita në ProCredit Bank, në emër të djalit, 5 751 lekë.
Interesa nga depozita në ProCredit Bank, në emër të djalit, 3 052 lekë
Mbyllje e depozitës në emër të djalit, 57 360 lekë.
Interesa nga llogaria e kursimit në emër të djalit, 449 lekë, 87 lekë.
Gjendje llogarie në ProCredit Bank 11 500 lekë, 28 000 lekë dhe 119 lekë.
Pakësim llogarie, 100 000 lekë.
Biznes person fizik Donald Gazidedja, 450 180 lekë.
Shpenzime për biznesin, 233 522 lekë.
Të ardhura nga paga si gjyqtare, 1 322 186 lekë.
Të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortit, 3 108 333 lekë.
Të ardhura nga qiraja e dyqanit, 306 000 lekë.
Të ardhura nga qiraja e një pjesë të shtëpisë, 168 000 lekë.
Të ardhura nga biznesi i djalit Donald Gazidedja, 182 500 lekë.
Të ardhura nga puna e djalit Donald Gazidedja, programim online, 500 euro.
Kontratë qiraje ambienti ku ushtron aktivitetin bashkëshorti, 7 000 lekë në muaj.
Kontratë qiraje ambienti ku ushtron aktivitetin djalit, 25 000 lekë.
Tarifë shkollimi e bashkëshortit tek shkolla e avokatisë në Tiranë, 30 000 lekë.

Tarifë shkollimi i deklaruës për titullin doktor shkencash, 213 000 lekë.
Tarifë shkollimi e djalit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, 25 000 lekë.
Tarifë shkollimi e djalit Alrdi Gazidedja, tek shkolla Protagonistët Tiranë, 144 000 lekë.
Tarifë për licencën e avokatisë së bashkëshortit, 112 000 lekë.
Intership kryer nga djalit në konsullatën shqiptare në Milano në Itali, 250 euro.
Blerje me internet card nga djalit Donald Gazidedja, 13 642 lekë.
Tokë arë në Dibër, figuron në emër të babit tim, Agim Gazidedja, 1920 m2.
Aksione në shoqërinë Albtelekom, blerë me bono privativi, në emër të Dritan Gazidedja, pasi ka qenë punonjës i ndërmarrjes, e cila u privatizua.

ADELAJDA GJUZI
GJYKATA E BERATIT (2016)

Hua pa afat për blerje apartamenti, 1 680 000 lekë.
Pasuri në përdorim, i llojit garazh në Selitë, 12 mijë euro.
Gjendje cash, 10 000 lekë.
Llogari rrjedhëse nga paga, 56 836 lekë.
Paga si ndihmëgjyqtare në Gjykatën e Lartë, 485 lekë.
Paga si gjyqtare, 447 582 lekë.
Të ardhura të përfituara nga Shkolla e Magjistraturës, 32 049 lekë.
Depozitë bankare, 143 340 lekë.
Depozitë bankare, 15 193 lekë.
Depozitë bankare, 280 127 lekë.
Kursime cash, 100 000 lekë.
Bashkëshorti magazinier tek 'Dule' sh.p.k, 501 600 lekë.
Administrator i 'XHS Bioproduct', me qendër në Fier.
Blerje pajisje kondicionimi, 460 588 lekë.

PAULIN ÇERA
GJYKATA DURRËS (2016)

14 dynym tokë mbjellë pemtari në Peshkopi.
Makinë Fort Focus, 2 500 euro.
Llogari bankare e pagës, 466 953 lekë.
Llogaria bankare e pagës, 580 623 lekë.
Kredi bankare, 500 000 lekë.
Overdraft, minus 242 746 lekë.
Bashkëshortja, e punësuar në Drejtorinë Arsimore Dibër, llogari bankare në BKT, 397 063 lekë.

AANTONETA PRENDI
GJYKATA E TIRANËS (2016)

Shitje e pasurisë së paluhatshme për blerje apartamenti në Tiranë, me sipërfaqe 86 m2, me vlerë 69 690 euro.
Të ardhura nga paga si gjyqtare, 1 120 150 lekë.
Të ardhura nga paga e bashkëshortit pranë shoqatës SOS, 734 102 lekë.
Të ardhura si eksperte për reformën në drejtësi, 29 523 lekë dhe 26 059 lekë.
Të ardhura nga puna e bashkëshortit, 100 000 lekë.
Huan shtetasit... 28 mijë euro për pagimin e këstit për blerjen e apartamentit.
Kredi për blerje apartament banimi, 3 475 000 lekë.
Bashkëpronësi e 12 000 m2 tokë, në fshatin Vithkuq të Korçës.

BRUNILDA KADI
GJYKATA E TIRANËS, ANËTARE E KLD, (2016)

Llogari rrjedhëse, pjesë e kursimeve nga pagat, 1 478 268
Depozitë në SHBA, 3 975 USD, krijuar nga puna e bashkëshortit.
Llogari rrjedhëse, 39 USD dhe 45 euro.
Llogari rrjedhëse në Shqipëri, 6 475 USD.
Cash krijuar nga puna e bashkëshortit në SHBA, 16 mijë USD.
Të ardhura nga paga, 1 140 885 lekë.
Pagesë nga Shkolla e Magjistraturës, 19 660 lekë.
Të ardhura si anëtare e KLD, 102 000 lekë.
Të ardhura si eksperte për reformën në drejtësi, 373 313 lekë.
Shërbim konsulence nga shoqëria, Ed-Konstruksion, pagesa në dy vite, 650 000 lekë.
Të ardhura të krijuara nga puna në SHBA si nënkontraktor në fushën e transportit, 23 mijë USD.
Kredi për mobilim shtëpie, 85 mijë euro, detyrimi i mbetur 16 973 euro.

Pasuria 2015
Shtesë në depozitë në SHBA, 2 986 USD.
Blerje makine, 1200 USD.
Paga si gjyqtare, 1,167,129 lekë.
Gazmend Kadi, 27 762 USD të ardhura në SHBA.
Gazmend Kadi, shlyer nga taksat federale 3 659 USD.
Kredi për mobilim shtëpie, 85 000 euro, deri në vitin 2028, shlyer 12 mijë euro.

ENKELEDA KAPEDANI
GJYKATA E ELBASANIT

Cash nga shitje e një are në Golem, 1 400 000 lekë.
Llogari rrjedhëse, 9 133 lekë.
Llogari rrjedhëse, 73 726 lekë.
Të ardhura nga paga dhe shpërblime, 20 860 lekë, 579 692, 50 000 lekë, 391 231 lekë, 7 500 lekë.
Kredi konsumatore, 1 000 000 lekë.
Bashkëjetuesi, shtëpi banimi me sipërfaqe 300 m2 truall dhe 156 ndërtesë, në Tiranë, 1/6 pjesë.
Tokë bujqësore, me sipërfaqe 26 580 m2, 1/6 pjesë.
Gjendje cash nga shitja e makinës, 400 000 lekë.
Dhënë hua shtetasit... 28 mijë euro.
Kontratë qiraje me afat njëvjeçar, 20 000 lekë në muaj.

ILIR ÇELIKU
ISH-GJYQTAR I APELIT NË VLORË

Shitur pasuria e paluhatshme në Tiranë, 250 mijë euro.
Paga si gjyqtar, 1 278 828 lekë.
Paga e bashkëshortes në shoqërinë përbarimore 'Sperd Solution', 211 365 lekë.
Paga e bashkëshortes në shoqërinë përbarimore..., 352 000 lekë.
Të ardhura të bashkëshortes si aksionere në shoqërinë përbarimore 'Sperd Solution', 2 589 786 lekë.
Shitja e kuotave nga bashkëshortja në shoqërinë përbarimore 'Sperd Solution', 50 000 lekë.
Kredi bankare në BKT, në shumën 50 mijë euro.
Shlyer kredia bankare, 2 538 000 lekë.
Bashkëshortja llogari rrjedhëse 105 mijë euro nga shitja e pasurisë së paluhatshme.
Llogari rrjedhëse 55 mijë euro nga shitja e pasurisë së paluhatshme.
Aksionere në shoqërinë përbarimore 'Sperd Solution', 50 % të kuotave janë dhuruar nga ortakut Arditi Hajdini.

KASTRIOT GRAMSHI
GJYKATA E TIRANËS

Apartament me sipërfaqe 63 m2, Tiranë, 48 mijë euro (kursime të akumuluar para emërimit si gjyqtar).
Shtëpi me sipërfaqe 180 m2, në Nju Jork, 184 mijë dollarë.
Të ardhura si gjyqtar, 1 076 512 lekë.
Të ardhura si lektor në SHBA, për periudhën mas-shtator 2016, 2 919 euro.
Të ardhura nga qiraja e apartamentit në SHBA, 9 800 dollarë.
IRS Tax Return 2015-2016, 18 242 dollarë.
Hua e dhënë pa interes 20 mijë dollarë.
Kredi në SHBA, për shtëpi banimi, 184 646 dollarë.
Depozitë në SHBA, 263 dollarë.

KLORINDA ÇELA
GJYKATA E TIRANËS

Të ardhura nga paga si gjyqtare, 1 081 326 lekë.
Paga e bashkëshortit, Ken Dhima, pranë Gjykatës Administrative në Vlorë, 1 071 389 lekë.
Të ardhura nga qiraja e ambientit të shërbimit, 1 732 000 lekë.
Të ardhura nga qiraja e njësisë së shërbimit në Tiranë, 748 000 lekë.
Të ardhura nga kontrata e kreditë bankare e lidhur me meje dhe bashkëshortit Ken Dhima, 21 000 000 lekë.
Detyrim nga shoqërisë për blerje njësi shërbimi, shlyer 50 mijë euro, mbetur 55 mijë euro.
Detyrim huaje ndaj një shtetasit, shlyer 14 000 000 lekë, mbetur 700 000 lekë.
Ken Dhima, Apartament banimi me sipërfaqe 51,65 m2, pjesa 1/5, sipas vërtetimit të dokumentit hipotekor, datë 01.03.2014. (Për këtë ambient, i cili është rezultat i ligjit nr. 7652, kamë marrë djeni nga babai im vetëm në tetor të vitit 2016. Për këtë arsye nuk e kam deklaruar këtë pasuri në deklaratat periodike të pasurisë. Kam menduar se ka qenë regjistruar vetëm në emër të babit).

KRISTI GONGO
TIRANE

Më në fund ministrat teknikë të propozuar nga Partia Demokratike dorëzuan dje formalisht dorëheqjen e tyre, pas 3 muajve në detyrë nga marrëveshja e 18 majit mes kryeministrit Edi Rama dhe kryepozitarit, Lulzim Basha. Zëvendës kryeministrja, Lendina Mandija dhe ministrat Dritan Demiraj, Helga Vukaj, Mirela Karabina, Gazmend Bardhi, Xhuljeta Kërtusha e Arben Beqiri i kanë dorëzuar Ramës dorëheqjen në mënyrë elektronike. Bashkë me dorëheqjen, zëvendësministrja Mandija ka dorëzuar edhe raportin për zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit, arsyeja që i mbante 'peng' teknikët që po vazhdonin të qëndronin në krye të detyrës. Pasi kanë kaluar dy muaj nga procesi zgjedhor ku ministrat e PD u emëruan nga Rama me propozim të Bashës si garanci për zgjedhjet parlamentare, dhe ku Partia Demokratike nuk arriti të fitonte, tashmë ministrat teknikë nuk i lidh më asgjë me kabinetin qeverisës. Roli i ministrave në qeveri ishte të kontrollonin sjelljet e administratës përgjatë gjithë procesit elektoral në mënyrë që të mbrohej vota e lirë e qytetarëve shqiptarë. Gjatë fushatës së shkurtër elektorale ministrat denoncuan publikisht raste të ndryshme kur punonjës të administratës shkelën ligjin dhe ndikuan në procesin zgjedhor, denoncimet u shoqëruan edhe me pezullime nga vendi i punës. Ndërsa aktualisht vijojnë të jenë ende pjesë e qeverisë "Rama", ministrat e Lëvizjes Socialiste për Integrim, të cilët pritet të shihet si do të reagojnë, nëse

MINISTRAT QË U LARGUAN NGA QEVERIA "RAMA":	
Lendina Mandija	Zëvendëse kryeministre
Dritan Demiraj	Ministri i Brendshëm
Helga Vukaj	Ministre e Financave
Mirela Karabina	Ministre e Arsimit
Gazmend Bardhi	Ministër i Drejtësisë
Xhuljeta Kërtusha	Ministre e Mirëqenies Sociale
Arben Beqiri	Ministër i Shëndetësisë

Dorëheqja

Më në fund ministrat teknikë të propozuar nga Partia Demokratike dorëzuan dje formalisht dorëheqjen e tyre në mënyrë elektronike, pas 3 muajve në detyrë nga marrëveshja e 18 majit mes kryeministrit Edi Rama dhe kryepozitarit, Lulzim Basha.



Ikin teknikët e PD-së, arrijnë në Kryeministri dorëheqjet

Ministrat largohen elektronikisht. Ish-kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: Duhet të rrinë në detyrë deri në shtator

do të japin dorëheqjen apo do të presin formimin e qeverisë së re në shtator; kurse ministrat teknikë të Partisë Demokratike u kanë kaluar të gjitha kompetencat e tyre zëvendës ministrave, të cilët do të drejtojnë ministratë deri në ardhjen e ministrave të rinj në shtator.

"MINISTRAT DUHET TË RRIËNË NË DETYRË DERI NË SHTATOR"

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë saktëson se ministrat duhet të qëndrojnë

KUSHTETUTA

"Kryeministri dhe ministrat janë të detyruar të qëndrojnë në detyrë deri në formimin e Këshillit të Ministrave pasardhës", thuhet në nenin 106 të Kushtetutës.

në detyrë deri në ardhjen e zëvendësuesve. "Kryeministri dhe ministrat janë të detyruar të qëndrojnë në detyrë deri në formimin e Këshillit të Ministrave pasardhës", thuhet në

nenin 106 të Kushtetutës. Të njëjtën gjë e deklaroi edhe ish-kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kristaq Kume në një lidhje telefonike për Report Tv, i cili shpre-

het se ministrat teknikë e përfunduan misionin e tyre, por duhet të rrinë në detyrë, qoftë edhe formalisht deri në krijimin e qeverisë së re. "Dorëheqja është një akt personal, por për aktin konkret kemi të bëjmë me zbatimin e marrëveshjes së 18 majit për zgjedhjet. Me ç'dukut misioni i tyre ka përfunduar dhe në pajtim me atë që është rënë dakord nuk vijojnë të qëndrojnë më. Një ministër pavarësisht emërimit, teknik apo jo, ka vetëm një nocion,

kur ndodhemi në situatën pas përfundimit të zgjedhjeve dhe kohës së duhet për mbledhjen e Kuvendit të ri, sipas Kushtetutës ministrat duhet të qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjen e krijimit e qeverisë së re, pavarësisht se mund të deklarohen apo jo për dorëheqje. Formalisht japin dorëheqjen, por kushtetuta detyron të vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë derisa të formohet qeveria e re" deklaroi Kume në lidhje me largimin e ministrave teknikë.

Demiraj: Nuk do jem pjesë e qeverisë "Rama 2"

Reagimi, Ministri i Brendshëm theu heshtjen e teknikëve pas dorëheqjeve

Ka qenë Ministri i Brendshëm, Dritan Demiraj i cili theu heshtjen e ministrave teknikë pas dorëheqjeve të dorëzuara në Kryeministri në mënyrë elektronike. Demiraj ka reaguar me një status në rrjetin social Facebook ku ka listuar arritjet e tij gjatë tre muajve që drejtoi Ministrinë e Brendshme, teksa thekson se në fokusin e tij ka qenë lufta kundër drogës. "Prioriteti im për tolerancë zero ndaj drogës në bashkëpunim me policinë e shtetit prodhoi disa rezultate të dukshme: 37 tone kanabis i sekuestruar, 40 mijë rrënjë kanabis të shkatërruara, 13 skafe të konfiskuara dhe mbi 75 vetë të arrestuar për kultivim dhe trafikim të lëndëve narkotike. Masat për të goditur fenomenin e kanabisit kanë qenë maksimale duke i drejtuar operacionet dhe arrestimet dhe personalisht në terren dhe jo masa propa-

gandistike. Bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme, Shërbimin Informativ dhe të gjitha institucionet e përfshira në planin e masave ka qenë shumë i lartë, intensiv dhe smart. Kontrolli absolut i territorit ka qenë dhe do të jetë detyrë që çdo individ me uniformë policore duhet të angazhohet maksimalisht" shkruan Demiraj. Ndër të tjera, Demiraj konstaton se ka individë të korruptuar në polici. Unë, ashtu si dhe çdo qytetar i këtij vendi, mendoj se ka individë të korruptuar, të implikuar e kontribues ne ideimin dhe zbatimin e të ashtuquajturit plan i kanabizimit të vendit" deklaroi ai.

MIRËNJOHJA

Ndërkaq, ai është mirënjohës ndaj kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Bashës që i ka besuar të drejtojë këtë



dikaster në një moment të vështirë për vendin. Gjithashtu, Demiraj përmend edhe bashkëpunimin e tij me kolegët që bënë të mundur përballimin e sfidave. "Dëshiroj që ti shpreh mirënjohjen më të thellë kryetarit të Partisë Demokratike, Z. Lulzim Basha për besimin për të kryesuar këtë dikaster

në një moment të vështirë për vendin dhe për mbështetjen e tij të vazhdueshme për të realizuar detyrat tona kushtetuese. Bashkëpunimi me kolegët në qeveri, dhe gjithë agjencive ligjzbatuese të vendit, kanë qenë në frymën institucionale dhe me këtë rast shpreh një falenderim të madh për përballimin

Reagimi

Demiraj ka reaguar me një status në rrjetin social Facebook ku ka listuar arritjet e tij gjatë tre muajve që drejtoi Ministrinë e Brendshme, teksa thekson se në fokusin e tij ka qenë lufta kundër drogës.



e një sërë sfidash të mëdha siç ishin mbarëvajtja pa incidente e procesit zgjedhor, lufta pa kompromis ndaj kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, trafikimit të qenieve njerëzore, lufta kundër terrorizmit, emergjencave civile dhe sigurimi i një sezoni turistik të qetë", vijon me tej ministri teknik.

"NUK DO JEM PJESË E QEVERISË "RAMA 2""

Demiraj u ka dhënë një përgjigje edhe aludimeve në media se mund të jetë pjesë e kabinetit 'Rama 2'. "Mendoj se duhet të sqarohet se çdo kontribut i imi në qeverisje është bërë në funksion të realizimit të qëllimeve të treguara më lart në kuadër të detyrës time si ministër teknik, e sigurisht jo në kuadër të përfshirjes time në qeverinë e ardhshme të mazhorancës aktuale", thotë Demiraj. Megjithatë, ai shpreh vendosmërinë për të kontribuar në lidhje me çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare. "Kam qenë dhe vazhdoj të jem i vendosur për të kontribuar në drejtimin e agjencive ligjzbatuese që merrem me çështje të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare. Punë të mëdha e presin përpara Shqipërinë!", përfundon statusin Dritan Demiraj.

Ja “provat” e teknikëve për deformimin e zgjedhjeve

Ministrat e Partisë Demokratike vetëm hamendësime dhe pretendime për zgjedhjet e qershorit, asnjë fakt konkret

KRISTI GONGO
TIRANE

Raporti përfundimtar i ministrave teknikë për zgjedhjet e qershorit, ku sipas tyre vërtetohet blerja e votës, është shumë voluminoz, por plot me hamendësime dhe pretendime e asnjë fakt konkret. Shumica e shkeljeve janë argumentuar në mënyrë përgjithëse, ndërsa edhe aty ku jepen disa raste konkrete janë ato përplajse që janë bërë publike midis ministrave teknik dhe vartësve të tyre të Partisë Socialiste. Teknikët që u emëruan në detyrë nga kryeministri sipas propozimit të kryepozitarit Lulzim Basha, raportojnë se në mbledhjet e Task-Forcës nuk kanë marrë pjesë në asnjë mbledhje Ministri dhe mazhorancës, anëtarë të Task-Forcës; nuk kanë marrë pjesë përfaqësuesi i Prokurorisë dhe KQZ, në cilësinë e subjekteve të ftuara. Pra sipas raportit përfundimtar të ministrave teknikë rezultojnë se i kanë zhvilluar të vetëm gjashtë mbledhjet e Task-Forcës. Monitorimi i veprimtarisë së administratës gjatë fushatës zgjedhore në zbatim të marrëveshjes politike të datës 18.05.2017 PS-PD, është realizuar nga ana e Task Forcës si dhe të grupeve të monitorimit në institucione të ngritura për këtë qëllim në bazë të VKM nr. 473, datë 01.06.2017 “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo

përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017” si dhe të kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, ministrat teknikë kanë raportuar ‘provat’ për deformimin e zgjedhjeve, të cilat janë përmbledhur më poshtë.

-Ministri teknik i Drejtësisë, Gazment Bardhi, në ushtrim të funksionit të monitorimit ka kërkuar hapjen e një portali, me qëllim denoncimin e rasteve të administratës në zgjedhje, por sipas tij Sekretarja e Përgjithshme Juliana Hoxha ka urdhëruar heqjen e portalit, si dhe u ka kërkuar punonjësve të mos zbatojnë urdhrat e ministrit. Bardhi ka informuar Kryeministrin dhe DAP për marrjen e masave ndaj këtyre shkeljeve ‘penguase dhe aspak bashkëpunuese’, por deklaroi se nuk ka marrë asnjë përgjigje. Gjithashtu, ministri teknik Bardhi ka pezulluar Juliana Hoxhën nga pozicioni i Sekretares së Përgjithshme, pasi ajo edhe pse kandidonte për deputete në PS vazhdon të detyrën në Ministrinë e Drejtësisë.

-Ministri teknik i Arsimit dhe Sporteve, Mirela Karabina, shprehet se është penguar për të përmbushur detyrat si anëtar i Task-Forcës nga Sekretari i Përgjithshëm, Plarent Ndreca dhe nëpunësve civilë të MAS, duke e cilësuar këtë sjellje të qëllimshme. Karabina sjell shembullin e mungesës së etikës, ku përmend korrigjimet me shkrim dore që SP iu bënte shkresave të ministrit dhe bllokimin drejtpërsëdrejti të e-mailit deri në datë 03.06.2017. Veç të tjerash, Karabina deklaroi se Ndreca ka ushtruar presion mbi stafin e Ministrisë nëse do të mbanin komunikim me ministrin dhe kabinetin e saj, duke penguar drejtoritë dhe punonjësit civilë të niveleve më të ulëta të zbatojnë urdhrat e Ministrit (përmendin rastin e Alqi Kushit, drejtor i SHM; rasti i Kolekës, drejtor i IT, etj që kanë shpërfillur urdhrat e ministrave Karabina). Plarent Ndreca është kallëzuar nga Karabina edhe për ndërhyrje në procesin e maturës shtetërore në Fushë-Krujë, ku ai ka hyrë në ambientet e shkollës “Shote Galica”, i paautorizuar, me qëllimin favorizimin e të rinjve që votonin për herë të parë, në mbështetje të Partisë Socialiste. Ndër të tjera, Karabina deklaroi se znj. Koleka me urdhër të Ndrecës, ka refuzuar të publikojë në faqen zyrtare të MAS deklaratat për shtyp të saj.

-Ministri teknik i Mirëqenies Sociale, Xhuljeta Kërtusha, në raportin përfundimtar adreson problematikat pothuajse të njëjta me ato të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, si presion të drejtpërdrejtë tek punonjësit civilë të niveleve më të ulëta për të refuzuar autoritetin e ministrit, ka fshehur në mënyrë abuzive shkresa hyrëse drejtuar Ministrit, ka refuzuar të firmosë çdo shkresë si dhe shkresat drejtuar Kryeministrit, ka ushtruar presion dhe kontroll verbal tek zyra e financës duke penguar të gjitha pagesat për të përndjekurit politikë, të cilat janë detyrim ligjor dhe duke lejuar pagesa selektive. Madje sipas Kërtushës, asistentja e ish ministrit, Olta Xhacka ka arritur deri

në ekstreme duke bërë presion mbi njësitë e prokurimeve, të cilat më pas janë ankuar vetë tek stafi i ministrit dhe ka penguar Ministrin e MMRS ushtrorë funksionet e saj dhe veçanërisht në drejtim të procesit të monitorimit referuar VKM 473/2017. Sipas informacionit të përcjellë nga Ministri, Artur Micko i komanduar Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit ka refuzuar të shqyrtojë në mënyrë objektive rastet e përfshirjes në fushatë të punonjësve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe t'i shkarkonte nga detyra sipas propozimit të Ministrit, pasi sipas Xhuljeta Kërtushës Micko ka qenë subjektiv për sa kohë ai ka mbajtur deri vonë pozicionin e kryetarit të FRESH-it.

-Ministri teknik i Financave, Helga Vukaj është përballur me problematika të ngjashme si ministrat e tjerë, si për shembull kërkesa për vënie në funksion të numrit jeshil 0800 1963, numër të cilin Ministria e ka pasur më parë në funksionim, me qëllim marrjen e denoncimeve që sipas Vukaj, nuk është zbatuar për asnjë moment nga administrata e Ministrisë. Helga Vukaj ka kërkuar masa disiplinore për punonjës të Ministrisë, të cilët refuzuan zbatimin e urdhrat të Ministrit për të qenë pjesë e grupit të punës për monitorimin e administratës shtetërore, si edhe përgjigjes për monitorimin e mospërdorimit të asetëve shtetërore, por ministrja teknike konstaton se pas mbledhjeve përkatëse të komisioneve të disiplinës, për asnjë nga rastet nuk është marrë masë disiplinore duke dalë me vendime pa masë, pavarësisht se sipas MF shkeljet ishin të provuara, argumentuara dhe dokumentuara. Gjithashtu Ministria teknike e Financave konstaton neglizhencë për administratën tatimore në përcjelljen e të dhënave të kërkuara, e cila nuk identifikoi kontrollat tatimore dhe rimbursimeve, një nga detyrat e lëna nga Task Forca.

-Ministri teknik i Shëndetësisë, Arben Beqiri konstaton mungesë bashkëpunimi në monitorimin e zgjedhjeve, megjithatë ai pranon se nuk ka pasur dinamikë përplasjes në Ministrinë e Shëndetësisë. Ministri teknik në raportin përfundimtar deklaroi se një pjesë e mirë e këtyre nëpunësve civilë, kryesisht me ata të nivelit të lartë drejtues, kanë fituar vendin e punës jo me anë të konkurrencës, por sipas tij duke u emëruar politikisht pa konkurs dhe duke u konfirmuar më pas në detyrë për shkak të efekteve të ligjit të ri për nëpunësin civil. Kjo frymë politizimi për teknikun e PD është përçarur edhe tek punonjësit e shërbimit civil të niveleve më të ulëta. Ministri teknik Beqiri raportoi i bindur se nëpunësit civilë të lartë nuk janë të pavarur politikisht, i cili sjell shembullin e Genc Gjonçaj, duke e konsideruar si shembullin më tipik të një Sekretari të Përgjithshëm politik, dhe sipas tij është fakt i njohur e që mund të verifikohet lehtësisht se ka qenë në kohën e emërimit përfaqësuesi i subjektit politik Partia Socialiste. Ndër të tjera, Beqiri përmend rastin e Ministrit të Financave dhe Zëvendësministrit të Financave, Znj. Irena Beqiraj, që sipas tij, nën justifikimin se mbronte nëpunësit civilë në Ministrinë e Financave, ka vepruar në shkelje të autoritetit të ministrit si titullari më i lartë në institucion duke çenuar hierarkinë administrative si dhe është sjellë në mënyrë tërësisht jo etike sipas ministrit, duke bërë edhe deklarata publike në media dhe rrjete sociale aspak serioze dhe të denja për një funksionar të lartë të administratës.

Mungesat

“6 mbledhje Task-Force, vetëm me ministra teknikë”

Edhe prokuroria nuk ka dërguar përfaqërfaqësues

Ministrat teknikë raportojnë se Task-Forca ka zhvilluar gjashtë mbledhje deri në datën e hartimit të këtij raporti, konkretisht në datat 05.06.2017, 16.06.2017, 20.06.2017, 21.06.2017, 23.06.2017 dhe 25.06.2017. Ata deklarojnë se ka pasur pjesëmarrje të rregullt të Ministrave të propozuar nga opozita, Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtorit të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave, SP të Këshillit të Ministrave, ndërsa për ministrat e tjerë, anëtarë të Task-Forcës deklarohen se kanë refuzuar të marrin pjesë. Ministrat teknikë duke vlerësuar kontributin e dhënë nga ana e Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil dhe pjesëmarrjen aktive në mbledhjet e Task-Forcës, konstatojnë se raporti i komisionerit nuk është i paanshëm siç duhej të ishte duke qenë se është hartuar nga një institucion i pavarur. “Komisioneri përkundrazi ka përkrahur çdo iniciativë të DAP dhe është nxituar të kryejë vendimmarrje të shpejta dhe pa hetim të thelluar adminis-

trativ apo në disa raste nuk ka ndërmarrë veprime fare”, shkruhet në raportin e tyre. Ndërsa në lidhje me bashkëpunimin me Prokurorinë e Përgjithshme, ministrat teknikë theksojnë se sipas nenit 23 të VKM 473/2017 ftohet të marrë pjesë dhe një përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme, dhe ata shprehen se ajo është ftuar të përcaktojë përfaqësuesin e saj në Task-Forcë, por në asnjë rast nuk ka njoftuar për një të tillë dhe se nuk ka ndonjë arsye specifike për mos marrjen pjesë në mbledhjet e Task-Forcës. E pranishme në mbledhjet e Task-Forcës duhet të ishte dhe një përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por pavarësisht njoftimeve përmes adresës zyrtare të e-mail, Klement Zguri nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Task-Forcës sipas ministrave teknikë. Megjithatë, teknikët shprehen se KQZ dhe kryetari Zguri kanë qenë mjaft bashkëpunues gjatë procesit të monitorimit të realizuar nga Task-Forca, duke dhënë informacionet e kërkuara përmes shkresave zyrtare.



Knut Fleckenstein rrëzon raportin e teknikëve të PD-së

“Duhet të presim që Raporti i OSBE-së të vlerësojë nëse është bërë gjithçka e mundur për të garantuar lirinë e votave”



KLAUDJA KARABOLLI
TIRANE

→ PËR RAPORTIN

“Raporti i ministrave teknikë jo domosdoshmërisht do të ndikojë negativisht në procesin e integritetit të vendit. Më e rëndësishme është nëse OSBE/ODIHR ka vërejtur të njëjtat shkelje dhe nëse po, se si qeveria do të merrte me to”.

thotë se kishte besim tek ministrat teknikë, por vetëm raporti i OSBE/ODIHR përcakton nëse ata kanë bërë gjithçka për garantimin e votës së lirë. Knut Fleckenstein shtoi se

rikonfirmimi i qeverisë Rama për një mandat të dytë qeverisës nuk është rrezik për demokracinë, si kundër pretendojnë përfaqësues të opozitës shqiptare.

-A do të ndikojë negativisht raporti i ministrave të opozitës për zgjedhjet parlamentare 2017 në integritetin e Shqipërisë?

Raporti i ministrave teknikë jo domosdoshmërisht do të ndikojë negativisht në procesin e integritetit të vendit. Më e rëndësishme është nëse OSBE/ODIHR ka vërejtur të njëjtat shkelje dhe nëse po, se si qeveria do të merrte me to.

-Shkelja e lirisë së votës vazhdon ende si fenomen, a mendoni se qeveria

→ VLERËSIMI REAL

“Isha shumë i sigurt se “ministrat e ri teknikë” do të bënin çmos për të garantuar lirinë e votave. Por tani duhet të presim që Raporti i OSBE-së të vlerësojë nëse është bërë gjithçka e mundur për të garantuar lirinë e votave”.

shqiptare ka bërë mjaftueshëm për të garantuar këtë liri?

Isha shumë i sigurt se “ministrat e ri teknikë” do të bënin çmos për të garantuar lirinë e votave. Por

tani duhet të presim që Raporti i OSBE-së të vlerësojë nëse është bërë gjithçka e mundur për të garantuar lirinë e votave të qytetarëve shqiptarë.

-Qeveria e ‘Rama 2’ për shkak të 74 mandateve është sot më e fortë, opozita vazhdon të jetë e dobët. Çfarë garancie kanë qytetarët shqiptarë për demokracinë?

Nuk kam dyshim se partitë e opozitës do të kenë një vështrim të afërt për procedurat dhe sjelljet e qeverisë. Sigurisht që ata do të informojnë publikun për vëzhgimet e tyre dhe qasjet alternative për mënyrën e mundshme të qeverisjes. Një shumicë absolute nuk është një rrezik për demokracinë.

KAMPINGU I LRI

Vasili: Nëse votat s’do ishin blerë do kishim dyfishin e rezultatit

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI: Opozita nuk është çështje numrash

Kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integritet, Petrit Vasili, ishte pjesë e një bashkëbisedimi me të rinjtë dhe të rejtat e Lëvizjes Rinore për Integritet në kampin e Jalës, ku ka diskutuar me ta në lidhje me aktualitetin politik në vend, si dhe për mundësitë që të rinjtë kanë të marrin vetëm fatet e vendit në dorën e tyre. Vasili u shpreh se LSI-a arriti rezultatin e saj më të lartë në zgjedhjet e fundit, por sipas tij ky rezultat mund të ishte edhe më i mirë nëse nuk do të kishin ndikuar parët e drogës dhe të kriminelëve. “Sot jemi në një situatë të re politike, jo për partitë që janë në qarkullim, por për situatën që prodhuan zgjedhjet. Është një fakt i padiskutueshëm që LSI-a



Vasili
“Megjithatë, ky është një rezultat shumë i mirë, i cili i përdorur si duhet, është një kapital i jashtëzakonshëm. Opozita nuk është çështje numrash, është çështje morali. Nëse je i vendosur qartë, nuk je i shitur dhe i blerë, nuk je i kapur dhe qëndron fort në çështjet parimore”.

arriti rezultatin e saj më të lartë ndër vite. Ky nuk është rezultat i vërtetë, pasi, në qoftë se nuk do të ishin zgjedhjet e drogës dhe kriminelëve, rezultati për LSI-në do të ishte dyfish”, tha Vasili, duke shtuar se opozita nuk është çështje numrash, por morali dhe se duhet qëndruar fort kundër padrejtësive që u bëhen qytetarëve nga një qeveri që është peng i interesave të shëmtuara. Gjithsesi, Vasili shtoi se rezultati ishte shumë

i mirë për LSI. “Megjithatë, ky është një rezultat shumë i mirë, i cili i përdorur si duhet, është një kapital i jashtëzakonshëm. Opozita nuk është çështje numrash, është çështje morali. Nëse je i vendosur qartë, nuk je i shitur dhe i blerë, nuk je i kapur dhe qëndron fort në çështjet parimore, mjaftojnë edhe 10 njerëz ta mbrojnë këtë çështje si duhet, dhe ajo bëhet çështje e të gjithëve”, tha Vasili.

RAPORTI

PS: Është jo korrekt dhe i paligjshëm

Ministrat teknikë me dorëzimin e dorëheqjes kanë paraqitur edhe një raport për zgjedhjet, ku theksojnë se votat u blenë. Ky raport u dorëzua në kryeministri nga zv kryeministrja Ledina Mandija. Teksa burime për Report TV nga PS thonë se ky raport është i paligjshëm pasi duhet të kalonte më parë nga Task Force. “Fakti është se raporti final i tyre mbi zgjedhjet është proceduralisht jo korrekt, pra i paligjshëm, sepse nuk është diskutuar dhe miratuar në mbledhjen e task-forcës sipas parashikimeve të VKM, e cila e legjitimoi task-forcën dhe përcaktoi funksionet e saj. Ajo task-forcë është krijuar mbi bazën e një VKM-je dhe është më e gjerë në përbërje se sa vetëm ministrat teknikë dhe çdo gjë duhet të diskutohej/votohej në task force”, thonë burime për Report TV nga PS. Nga ana tjetër ministrat teknikë thonë për Report TV se raporti është përmbljedhje e veprimtarisë së task force dhe task force e ka mbaruar veprimtarinë e vet, prandaj nuk është e nevojshme të mblidhet përsëri. “Për raportin ka reaguar edhe deputeti socialist, Erjon Braçe, i cili shprehet se është nul. “Po prova, prova a keni? Se raport paskeni shkruar. Është i njëjtë që prej 2001-shit! Ka një tip në PD që e ka raportin gati, ndaj e mbajnë të gjithë aty, thjesht për atë raport. Tani, raporte shkruan kushdo; puna është t’i provosh, domethënë të kesh prova të qarta e të pakundërshtueshme! Të thënat e Lulzim Bashës dhe çdo zari të tij që humbi më thellë se kurrë qarkun që kryesonte, nuk mund të jenë prova! Lulëllëqe patjetër që janë! Madje të përsëritura!”, shkruan Braçe.



LARGIMI I MINISTRAVE

Tritan Shehu: Fund spekulimeve për qeverisje PS-PD

Pas largimit të ministrave teknikë të Partisë Demokratike nga qeveria, Tritan Shehu ka reaguar duke shkruar se akti i tyre i dha fund spekulimeve për një qeverisje PS – PD. “Do largohen apo jo ministrat teknikë të PD nga Qeveria, do të ketë koalicion PD-PS, apo ndonjë prej tyre do të vazhdojë në Qeverinë Rama 2? Ishin “fantazitë” e kësaj vere duke u shtuar edhe dilemën e fabrikuar për koalicionin PD-LSI!”, shkruan deputeti i PD në një status në rrjetin social Facebook. Pak javë më parë në media u spekullua se ministri Demiraj mund të ishte pjesë e kabinetit ‘Rama 2’. Jo vetëm Shehu, por edhe Demiraj u ka dhënë një përgjigje aludimeve duke e mohuar një gjë të tillë. Ndër të tjera, Tritan Shehu, shton se dorëheqjet e teknikëve tregojnë një shembull përgjegjshmërie e transparence, si dhe premisën për një opozitë të vërtetë.

Votimi me detyrim, Kume kundër propozimit të PD

Aleati i Bashës kundër Edmond Spahos: Votimi i detyruar zhyt demokracinë

Ish-kreu i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kristaq Kume, komentoi për Report TV propozimin e PD për votimin me detyrim të zgjedhësve, duke u deklaruar kundër për disa arsye, të cilat i shpjegon. Kume thotë se, para se ta detyrosh tjetrin që të marrë pjesë në votim, duhet të zgjidhësh problemet e tjera për mundësinë që duhet të kenë shqiptarët për të votuar. "Jam njohur me propozimin, është problem dhe nuk është koha për ta propozuar, pasi që të detyrosh zgjedhësit të marrin pjesë në votim, përpara se të bësh këtë gjë duhet të zgjidhësh problemet e tjera për mundësinë që duhet të kenë shqiptarët për të votuar, kam parasysh ata që jetojnë jashtë vendit. Për mendimin tim është e domosdoshme që partitë të shohin atë që nuk kanë bërë për të rritur besimin e shqiptarëve. Kur zgjedhësi nuk është i sigurt për votën e tij është i demotivuar. Një nga arsyet që duhet trajtuar, ajo që mund të arrihet është shumë pak në krahasim me atë që kërkohet. Veprimi nuk sjell dot produkte për të rritur standardet dhe besueshmërinë e shqiptarëve në zgjedhje. Duhet të garantohet e drejta për të votuar në çfarëdolloj niveli dhe pastaj të mendojmë" përfundoi ai. Pak ditë më parë n/kryetari i PD, Edmond Spaho propozoi që pjesë e aksionit opozitar për reformën Kushtetuese dhe Zgjedhore duhet të jetë dhe detyrimi me ligj për të votuar në zgjedhje. Por, Kushtetua jonë e përcakton vetëm si të drejtë dhe jo detyrim



→ **ARTUR ROSHI**

"Në këtë rast vendosja e ligjit për të detyruar qytetarët të votojnë në zgjedhje është një masë shtrënguese që bie ndesh me filozofinë liberale. Nga ana tjetër ushtrimi i të drejtës së votës është një "e drejtë" e qytetarit dhe si e tillë nuk mund të detyrohet me ligj".

pjesëmarrjen në zgjedhje, ndërsa debati ka nisur në Evropë pas referendumit për

BREXIT. Propozimi i Spahos erdhi pas pjesëmarrjes së ulët në zgjedhjet e 25 qershorit dhe faktit që Rama mori mandatin e dytë me më shumë deputetë, ndërsa PD u penalizua, pasi i munguan 200 mijë vota nga 2013. Mbetet për t'u parë nëse Partia Demokratike do ta vendosë si kusht dhe do ta kthejë në kauzë votimin me detyrim në zgjedhjet e ardhshme lokale dhe parlamentare. Deri më tani ky propozim është artikulluar vetëm nga Edmond Spaho, i cili i përket linjës së Lulzim Bashës në PD.

ALEATI I BASHËS KUNDËR PD

Kundër propozimit të nënkryetarit PD, Edmond Spaho për votimin me detyrim ka dalë edhe aleati i PD, Artur Roshi, i cili është kryetar i Ballit Kombëtar. Ai thotë se kjo është një ide që nuk duhet vazhduar, pasi një ligj i tillë do ta zhysë demokracinë e pakët që kemi sot në një vakum funksional. "Dje në media pati jehonë një ide e z. Edmond Spaho, n/kryetar

Kristaq Kume

"Pasi që të detyrosh zgjedhësit të marrin pjesë në votim, përpara se të bësh këtë gjë duhet të zgjidhësh problemet e tjera për mundësinë që duhet të kenë shqiptarët për të votuar, kam parasysh ata që jetojnë jashtë vendit".



Kristaq Kume

i Partisë Demokratike, në lidhje me votimin e detyruar të shqiptarëve sepse zvogëlohet mundësia e blerjes së votës duke u rritur pjesëmarrja dhe këtë ligj e ka edhe Greqia. Çdo ide e hedhur në publik nga njerëz me influencë që u vjen nga pushteti politik që gëzojnë në një Parti politike, apo nga personaliteti i tyre kthehet në temë debati sepse ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në mënyrën e zgjidhjes së problemeve të shoqërisë, për rrjedhojë ndikojnë në jetët tona. Kjo na jep të drejtën morale të reagojmë, por sigurisht brenda arsyes dhe asaj që na bashkon

"e ardhmja e përbashkët" si opozitë dhe si qytetar. Desha të them se një ide e tillë nuk sjell shije të mirë për publikun kur vjen nga një Parti e qendrës së djathtë siç është Partia Demokratike", thotë Roshi.

ARGUMENTET KUNDËR

Kryetar i Ballit Kombëtar pohon se vendosja e ligjit për të detyruar qytetarët të votojnë në zgjedhje është një masë shtrënguese që bie ndesh me filozofinë liberale. "Së pari, mendoj se mungon argumenti politik që duhet të paraqesë një forcë politike liberale e qendrës së djathtë si PD, e cila mekanizmat politikë

i ngre mbi lirinë e individit duke zvogëluar ekzistencën e shtetit. Në këtë rast vendosja e ligjit për të detyruar qytetarët të votojnë në zgjedhje është një masë shtrënguese që bie ndesh me filozofinë liberale. Nga ana tjetër ushtrimi i të drejtës së votës është një "e drejtë" e qytetarit dhe si e tillë nuk mund të detyrohet me ligj. Sigurisht pajtohem me shqetësimin e blerjes së votës, por duhet gjetur mekanizmi për ta eliminuar. Unë kam bindjen e thellë se mospjesëmarrja në votime bëhet "pjesëmarrje" kur sigurohet realisht vota e lirë për qytetarët", thotë Roshi.



REPUBLIKA E SHQIPERISE

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

DREJTORIA E LICENCIMIT DHE MONITORIMIT TË TREGUT

NJOFTIM PËR LICENCIM

Në zbatim të nenit 40, të Ligjit Nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"; nenit 20 pika 2, të "Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Proçedurat e ERE-s"; nenit 10 pikat 8, 9 dhe 10, 11 të "Rregullores për proçedurat dhe afatet për dhenien, modifikimin, transerimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike", bëjmë me dije se, shoqëria "THE BLUE STAR" sh.p.k., ka aplikuar pranë Entit Rregullator të Energjisë, për tu pajisur me licencë në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike.

Me vendimin nr.131, datë 16.08.2017, Bordi i ERE-s, filloi procedurën për licensimin e shoqërisë "THE BLUE STAR" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

Të interesuarit që mendojnë se kanë interes mbi këtë çështje, ftohen të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim brenda 30 ditëve pune nga data e parë e publikimit të këtij njoftimi, pranë zyrave të ERE-s në adresën: Bulevardi "Bajram Curri", Rruga Viktor Eftimiu, 1023, Tiranë.

Ky njoftim do të botohet në datat 18.08.2017 dhe 19.08.2017 (dy dite me rradhë, data 18.08.2017 përfshirë).



REPUBLIKA E SHQIPERISE

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

DREJTORIA E LICENCIMIT DHE MONITORIMIT TË TREGUT

NJOFTIM PËR LICENCIM

Në zbatim të nenit 40, të Ligjit Nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"; nenit 20 pika 2, të "Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Proçedurat e ERE-s"; nenit 10 pikat 8, 9 dhe 10, 11 të "Rregullores për proçedurat dhe afatet për dhenien, modifikimin, transerimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike", bëjmë me dije se, shoqëria "THE BLUE STAR" sh.p.k., ka aplikuar pranë Entit Rregullator të Energjisë, për tu pajisur me licencë në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

Me vendimin nr.132, datë 16.08.2017, Bordi i ERE-s, filloi procedurën për licensimin e shoqërisë "THE BLUE STAR" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Të interesuarit që mendojnë se kanë interes mbi këtë çështje, ftohen të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim brenda 10 ditëve pune nga data e parë e publikimit të këtij njoftimi, pranë zyrave të ERE-s në adresën: Bulevardi "Bajram Curri", Rruga Viktor Eftimiu, 1023, Tiranë.

Ky njoftim do të botohet në datat 18.08.2017 dhe 19.08.2017 (dy dite me rradhë, data 19.08.2017 përfshirë).

Emërimi i bordit nga Karabina përplasje mes Kules dhe Konit

Rektori i UT: Vendimi i ish-ministres legjitim. Ish-rektori: Prek autonominë e universitetit



Mynyr Koni

Për emërimin e anëtarëve të rinj në Bordin e Administrimit të Universitetit të Tiranës, që u cilësua nga dekanët si shkelje e autonomisë, ka reaguar edhe rektori i Universitetit Mynyr Koni. Në një deklaratë për mediat Koni tha se vendimi i ish ministres teknike të Arsimit Mirela Karabina, është legjitim dhe konform ligjit të arsimit të

lartë. "Bordi i Administrimit është i përbërë nga 7 anëtarë, përfaqësues të stafit akademik që përzgjidhen nga Senati akademik, përfaqësues me mandat 5-vjeçar, si dhe përfaqësues të ministrisë së linjës, që emërohen nga ministri. Anëtarët e nominuar nga ministria e Arsimit është legjitim. Në Universitetin e Tiranës nuk ka ndodhur ndryshimi i anëtarëve të bordit përfaqësues të universi-

tetit, por ka ndodhur ndryshimi i anëtarëve të bordit përfaqësues të ministres së Arsimit. Në shkresën e ministres nuk ka asnjë lloj argumentimi", thotë Mynyr Koni, rektor i UT-së. Ndërsa dekani i fakultetit ekonomik, Dhori Kule shprehet se zëvendësimet e ndërmarra pa procedurë prekin autonominë e universitetit. "Në qoftë se universitetet dhe strukturat e tyre do të

ishin pre e vullnetit dhe dëshirave të ministrave që venë e vinë, nuk do të ishin më autonome. Ligji ka lënë hapësira për të ndërhyrë me argumenta me procedurë. Ministri i shkarkon, por i shkarkon me procedurë, dhe do duhet të komunikonte dhe konsultohet me drejtoritë", thotë Dhori Kule dekani i fakultetit ekonomik. Përmes një reagimi të bërë në lidhje emërimet e reja,

ish ministria Karabina ka thënë se ndryshimet janë bazuara në ligj dhe në përgjigje të shqetësimeve të autoriteteve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë publik. Të gjitha shkrimet dhe deklaratat, Karabina i cilësoi si të papërgjegjshme duke keqinformuar opinionin dhe, për më tepër, sipas saj, në kundërshtim me misionet e institucioneve të arsimit të lartë dhe interesit publik.

Cilësimi

TIRANE

Vodafone Albania është cilësuar Rrjeti më i Shpejtë i Telefonisë Celulare në Shqipëri, nga Ookla, Kompania ndërkombëtare lider në testimin e performancës së Internetit dhe në diagnostikimin e rrjetit, të testuar nga vetë konsumatori. Rezultatet e Speedtest nga Ookla tregojnë se shpejtësia e internetit të ofruar nga Vodafone Albania është mbi 60% më e lartë se operatorët e tjerë të telefonisë celulare në vend. Vodafone Albania është vlerësuar nga Ookla si rrjeti më i shpejtë i telefonisë celulare në Shqipëri. Certifikimi nga Ookla vjen si rezultat i testeve të kryera nga vetë përdoruesit nëpërmjet Speedtest nga Ookla, platforma më prestigjioze mbarë botërore për testimin e shpejtësisë së internetit. Ookla ka mbledhur rezultatet e testeve të kryera gjatë tremujorit të parë dhe të dytë të 2017 nga përdoruesit e internetit nëpërmjet telefonisë celulare në Shqipëri, të cilët kanë përdorur Speedtest nga Ookla për të testuar shpejtësinë e internetit në aparatit e tyre celular. Sipas raportit të Ookla për Shqipërinë, Vodafone Albania rezultoi me performancën absolutisht më të mirë, me shpejtësi interneti mbi 60% më të lartë se operatorët e tjerë të telefonisë celulare në vend. Speedtest nga Ookla, është lider në testimin e performancës së internetit dhe në diagnostikimin e rrjetit, të iniciuar nga vetë konsumatorët. Me mbi 9 milion teste të kryera çdo ditë dhe mbi 9 miliardë teste të regjistru-



Vodafone certifikohet nga Ookla si operatori me rrjetin më të shpejtë

ara deri më sot, "Speedtest" siguron pamjen më të zgjeruar të performancës dhe të qasjes në rrjetin botëror të internetit. Zv. Presidenti i Ookla, Jamie Steven, deklaroi se: "Ookla ka kënaqësinë të vlerësuar Vodafone Albania si Rrjetin më të Shpejtë të telefonisë celulare në Shqipëri për vitin 2017. Angazhimi që kjo kompani ka treguar në ofrimin e shpejtësive të jashtëzakonshme të internetit në celular, është mbresëlënëse dhe një benefit për klientët". Pas këtij vlerësimi, CEO i Vodafone Albania, Dietlof

Mare u shpreh se "Kënaqësia e klientit është esenciale për biznesin tonë dhe për këtë arsye ne jemi të lumtur të shohim angazhimin tonë dhe investimet në infrastrukturën e rrjetit të përkthyer në rezultate të jashtëzakonshme sipas vlerësimit të Speedtest nga Ookla. Ky certifikim është një tregues kryesor dhe një sfidë e madhe për ne që të vazhdojmë të ofrojmë eksperiencën më të mirë për klientët tanë në Shqipëri". Pozicioni i Lider-shipit që Vodafone Albania mban në tregun Shqiptar për sa i përket cilësisë më

të mirë të rrjetit, vjen si rezultat i investimeve të vazhdueshme në infrastrukturën e rrjetit dhe angazhimit të jashtëzakonshëm të kompanisë për të siguruar shërbime dhe produkte më cilësore për klientët e Vodafone. Në vitin e 16-të në tregun shqiptar, Vodafone, është në krye të zhvillimeve më të fundit teknologjike në vend dhe për këtë arsye, 6 nga 10 përdorues kanë zgjedhur të lundrojnë në rrjetin Vodafone, rrjeti absolutisht më i shpejtë dhe me mbulimin më të gjerë në të gjithë Shqipërinë.



Njoftimi i AMA

Nis digjitalizimi në Berat, ja ku mund ta gjeni Report Tv

Ka nisur procesi i digjitalizimit në qarkun e Beratit. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), ka njoftuar se në këtë qark janë fikur të gjitha transmetimet analoge dhe janë ndezur transmetimet numerike të operatorit publik, RTSH, dhe të operatorëve privatë kombëtarë: Digitalb, Klan TV, Top-Channel, Vizion+ dhe Adtn.

REPORT TV

Ndërsa Report Tv mund ta gjeni në numrin 16 tek telekomanda e televizorit tuaj. Nëpërmjet teknologjisë së re digjitale, publiku në qarkun e Beratit do të ketë mundësi të shikojë, gjatë gjithë kohës, një sërë programesh pa pagesë, të operatorit publik dhe atyre private. AMA njofton publikun në qarkun e Beratit të pajiset me marrës digjital (dekoder numversalë të tipit DVB-T2), pasi në të kundërt nuk do të ketë akses në transmetimet televizive.

KANALET DHE NUMRAT

1. Rtsh 1	11. Rtsh Muzikë
2. Rtsh 2	12. Rtsh Parlament
3. Rtsh 3	13. Rtsh Shqip
4. Top-Channel	14. Klan +
5. Klan Tv	15. Klan Shop
6. Vizion +	16. Report TV
7. ABC News	17. Tv Globe
8. Top News	18. TV Berati
9. Rtsh Sport	19. TV Onufri
10. Rtsh Art	

Mesila Doda: PDIU jashtë Kuvendit nga marrëveshja PS-PD

Votimi me detyrimi, vijojnë replikat mes sekretares së PDIU dhe nënkryetarit të PD, Edmond Spaho

Replikat mes N/kryetarit të PD, Edmond Spaho dhe Sekretares së PDIU, Mesila Doda, në lidhje me propozimin e Spahos që pjesë e aksionit opozitar për reformën Kushtetuese dhe Zgjedhore duhet të jetë dhe detyrimi me ligj për të votuar në zgjedhje, vijojnë ende. Në një status në facebook, të cilin Doda e cilëson si një replikë të fundit më N/kryetarit të PD, Spaho, i thekson atij faktin se kryetari i PDIU nuk është në parlament si rezultat i pazareve mes PD-PS. Gjithashtu Doda, marrjen si shembull të demokracisë greke nga Spaho e konsideron si servilosje, pasi sipas Dodës Greqia ka probleme të mëdha me respektimin e të drejtave të njeriut. "Një shënim i fundit... Për z. Spaho që me mirësjellje po na kujton marrëveshjen e natës PD-PS. Nëse jeni i shqetësuar se pse nuk është në Parlament kryetari i PDIU, duhet ta dini që ky është rezultati i pazarit të natës PS-PD. U dhanë 6 ministra teknikë dhe po aq drejtorë ekonomikë që fushata po edhe numërimi dhe tjetërsimi i votës të përqendrohej kundër partive të tjera, sepse le ta themi haptas... ky ishte pakti i dy të mëdhenjve kundër gjithë të tjerëve. Për



herë të parë u bënë bashke PD e PS që të mos hapeshin kutitë e Tiranës e të mos dilte në shesh zullumi i gjithëpërfshirjes në vjedhjen e votës në numërim, duke shënuar edhe rastin e parë kur një opozitë nuk dëshiron transparencë. Këto që po them janë fare pak në krahasim me atë të vërtetë që mbulon vjedhjen e mandatit të PDIU në Tiranë, dhe kalimin e këtij mandati në favor të PS", thotë zonja Doda. Gjithashtu Doda, marrjen si shembull të demokracisë greke nga Spaho e konsideron si servilosje, pasi sipas Dodës, Greqia ka probleme të mëdha me respektimin e të drejtave të njeriut. "E kam edhe një shqetësim të fundit. Mos e konsideroni më shtetin fqinj si yllin polar të demokracisë e mos ju servilosni. Ka probleme të mëdha me respektimin e të drejtave të njeriut dhe janë bashkombasit tuaj ata që janë vrarë dhunuar e vjedhur në pronë e identitet. E më së fundi më duhet të them që nuk ka ardhur asgjë e mirë nga ky nënshtrim për shekuj me radhë", shkruan Doda në facebook. Kushtetuta e Shqipërisë e përcakton vetëm si të drejtë dhe jo detyrim pjesëmarrjen në zgjedhje, ndërsa debati ka nisur në Europë pas referendumit për BREXIT.

NJOFTIMI I ANKANDIT



1. Autoriteti shites: Albpetrol sha Patos, Rruga Fier - Patos km 7

2. Data e zhvillimit të ankandit: 22/08/2017

3. Lloji i Procedurës standarde të ankandit: Procedure e hapur

4. Objekti i Shitjes: Shitje nafte brut, sasia 200 000 ton

5. Afati i evadimit: 365 dite nga data e nënshkrimit të kontratës

6. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes: Shitje e nafte brut, sasia 200 000 ton, ne pikat e levrimit CTF Marinez (Bankers/HUB Fier), Stacioni Usoje, 16/1 (ARMO) Ballsh, Stacioni Zharrez, Stacioni Sheqishte, Stacioni Gorisht, Stacioni Visoke, Stacioni Kuçove.

7. Vlera fillestare:

Ne kushtet FOB:

Çmimi minimal fillestar per njesi eshte:

71 % e Çmimit Brent + K

Ne pikat e levrimit:

Çmimi minimal fillestar per njesi eshte:

71 % e Çmimit Brent - 4 USD/bbl + K

- 71 % eshte koeficienti i cili perfaqeson karakteristikat mesatare te nafte (pesha specifike, aciditeti i nafte, % e sqfurit).
- Brent eshte çmimi ne \$/bbl i Brent i Platts, i publikuar ne Buletinin e Prokurimit Publik.

- 4 USD/bbl kosto mesatare totale (magazinin, stokim, analizim produkti).
- K- eshte vlera \$/bbl e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal te shitjes te perlogaritur nga formula ($K \geq 0$).

8. Vendndodhja e nafte brut: Albpetrol sha Patos

Ne pikat e levrimit CTF Marinez (Bankers/HUB Fier), Stacioni Usoje, 16/1 (ARMO) Ballsh, Stacioni Zharrez, Stacioni Sheqishte, Stacioni Gorisht, Stacioni Visoke, Stacioni Kuçove.

9. Vendi i zhvillimit të ankandit: Ministria e Energjise dhe Industrise, Sheshi Skenderbej, Tirane, salla e mbledhjeve kati I-re.

10. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: ne zyren e protokollit te Ministrise se Energjise dhe Industrise, datë 22/08/2017, ora 11:00

11. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund te terhiqen prane autoritetit shites me paraqitjen e nje kerkese me shkrim ose ne faqen zyrtare te "Albpetrol" sha www.albpetrol.al dhe ne faqen e Ministrise se Energjise dhe Industrise www.energija.gov.al.

Dokumente me pagesë:

Po Jo X

12. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, perpara dates dhe ores se zhvillimit te ankandit, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit.

Dyfishohet numri i vatrave, 14 në të gjithë vendin

Flakët rrezikojnë banesat në Gjirokastër dhe Finiq. Digjet një shtëpi në Vaun e Dejës

Pas reshjeve, duke sikur situata nga zjarret u stabilizua, por gjatë orëve të fundit situata paraqitet përsëri problematike, nga 7 numri i vatrave është dyfishuar në 14. Temperaturat e larta kanë sjellë shtimin e vatrave të zjarrit në vend nga veriu në jug, ndërsa disa prej tyre vijojnë të jenë aktive prej disa ditësh. Në fshatin Vig, Bashkia Vau Dejës është djegur një banesë nga zjarri, 20 koshere me bletë dhe një sipërfaqe relativisht e madhe pylli me shkurre dhe pisha. Në fshatin Janicat dhe Cercovicë, Bashkia Finiq, zjarret kanë marrë përmasa duke rrezikuar seriozisht banesat e këtyre dy fshatrave, por pas disa orësh fshatrat janë izoluar. Në fshatin Kudhës të Bashkisë Himarë ka rënë zjarr në pyllin me shkurre, mare, pemë frutore dhe ullinj. Në fshatin Shtëpëz, Picar, Bashkia Gjirokastër është riaktivizuar një vatër zjarri në vendin e quajtur "Shkalla e Zezë", që nisi të merrte drejtim nga banesat e fshatit. Zjarri është izoluar, por nuk është shuar plotësisht. Si pasojë e zjarrit u dogj sipërfaqe e mad-

Numri i vatrave
Pas reshjeve, duke sikur situata nga zjarret u stabilizua, por gjatë orëve të fundit situata paraqitet përsëri problematike, nga 7 është dyfishuar numri i vatrave në 14.



Zjarret në Dibër

Prefekti: Policia në Bulqizë dhe Mat s'ka gjetur autorët e zjarreve



Ardit Kaja

Prefekti i Qarkut të Dibërës, Ardit Kaja ka shprehur në mbledhjen e radhës ankesën për dy institucionet e komisariateve të policisë Bulqizë dhe Mat për faktin se nuk kanë identifikuar autorët të cilët kanë vënë zjarre të qëllimshëm. Ndërsa Kaja disa ditë më parë ka dhënë një tjetër intervistë në të cilën shprehet se Bashkia Bulqizë

ka qenë një bashki tepër problematike, pasi ka pasur një numër të lartë të vatrave të zjarrit. Sipas Kajës nuk ka pasur asnjë angazhim nga Bashkia e Bulqizës për fikjen e zjarreve, por vetëm nga institucioni i zjarrfikësës. Kaja u bëri thirrje të gjithë instancave përkatëse që në vitin 2018 mos të përsëriten këto raste me zjarrvënien të qëllimshme.

he me shkurre dhe kullotë. Në operacione për shuarjen e zjarreve janë angazhuar 106

punonjës zjarrfikës, 20 automjete zjarrfikëse, 140 personel nga Forcat të Armatosura të

Ushtrisë, dhjetëra punonjës të Pyjores, të bashkive dhe qytetarë vullnetarë etj, të

mbështetur nga helikopterë. Specialistët e Emergjencave Civile, janë duke mbajtur situatën në monitorim të vazhdueshëm në të gjithë vendin. Ndërsa, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave

Civile, në Ministrinë e Punëve të Brendshme përsërit thirrjen ndaj të gjithë qytetarëve që në rast se konstatojnë zjarre, të njoftojnë menjëherë në numrat e emergjencave 112, 129 dhe 128.

Situata e zjarreve sipas Emergjencave Civile:

SHKODËR

Në fshatin Vig, Bashkia Vau Dejës ka rënë zjarr në shkurre dhe ferra pranë banesave, i cili me pas është përhapur në një pyll me pisha. Forcat zjarrfikëse dhe punonjës të pyjores kanë punuar për të izoluar dhe shuar flakët, dhe operacioni është në vazhdim. Si pasojë është djegur një banesë pranë vatrës së zjarrit, 20 koshere me bletë dhe një sipërfaqe relativisht e madhe në pylli me shkurre dhe pisha.

KUKËS

Në fshatin Nimçe, Bashkia Kukës ka rënë zjarr në shkurre dhe pisha. Zjarri është shuar nga punonjës bashkiakë dhe banorë të zonës duke mos lejuar shkaktimin e dëmeve ekonomike.

LEZHË

Në fshatin Selitë, Bashkia Mirditë ka rënë zjarr në shkurre dhe ferra pranë një pylli me pisha. Zjarrfikësit me mjete kanë punuar duke izoluar zjarrin që të mos prekej pylli me pisha. Në fshatin Orosh, Bashkia Mirditë ka rënë zjarr në shkurre dhe ferra pranë pyllit me pisha. Zjarrfikësit me mjete kanë punuar për të izoluar zjarrin që ende

rrezikon të kalojë në pyllin me pisha. Priten të shkojnë në ndihmë forca të ushtrisë.

TIRANË

Në fshatin Sineballaj, Bashkia Rrogozhinë ka rënë zjarr në një sipërfaqe me shkurre dhe pemë akacie. Zjarrfikësit me mjete kanë shuar zjarrin. Si pasojë e zjarrit u dogj një sipërfaqe prej rreth 0.5 ha me shkurre dhe 3 pemë akacie.

FIER

Në fshatin Darëzezë, Bashkia Fier ka rënë zjarr në një sipërfaqe me shkurre dhe pisha. Zjarrfikësit me mjete kanë shuar zjarrin. Si pasojë e zjarrit u dogj rreth 0.1 ha me shkurre dhe pisha. Në fshatin Shtyllas, Bashkia Fier ka rënë zjarr në shkurre dhe kallama pranë një ullishteje. Zjarrfikësit me mjete kanë shuar zjarrin. Si pasojë e zjarrit u dogj rreth 0.4 ha me shkurre dhe kallama.

VLORË

Në fshatin Janicat dhe Cercovicë, Bashkia Finiq, zjarret kanë marrë përmasa duke rrezikuar seriozisht banesat e këtyre dy fshatrave. Punonjës të Bashkisë Finiq kanë punuar me mjete rrethore për të izoluar

zjarrin e rënë në terrenin tepër të thyer, por flakët të favorizuara nga era kanë dalë jashtë kontrollit. Në vendngjarje kanë shkuar forca zjarrfikëse me mjete e forca ushtarake dhe të gjithë së bashku kanë bërë të mundur izolimin e vatrave të zjarrit duke shmanjur rrezikun për banesat e dy fshatrave. Në fshatin Kudhës të Bashkisë Himarë ka rënë zjarr në pyllin me shkurre, mare, pemë frutore dhe ullinj. Zjarrfikësit nuk kanë mundur të ndërhyjnë me mjete për shkak të terrenit tepër të thyer por kanë punuar me mjete rrethore për të mbrojtur banesat. Zjarri në këtë zonë pyjore nuk është shuar plotësisht dhe kërkon ndërhyrje nga ajri.

BERAT

Në fshatin Kutalli, Bashkia Ura-Vajgurore ka rënë zjarr në shkurre dhe ferra. Zjarrfikësit me mjete, të mbështetur edhe nga forca ushtarake, kanë izoluar zjarrin duke eliminuar rrezikun për banesat e fshatit. Si pasojë e zjarrit u dogj sipërfaqe e madhe me shkurre dhe ferra.

GJIROKASTËR

Në fshatin Hormovë, Bashkia Tepelenë ka rënë zjarr në shkurre dhe kullotë. Në

vendngjarje kanë shkuar zjarrfikësit me mjete duke izoluar vatrën e zjarrit. Si pasojë e zjarrit u dogj një sipërfaqe relativisht e madhe me shkurre dhe kullotë. Në fshatin Shtëpëz, Picar, Bashkia Gjirokastër është riaktivizuar një vatër zjarri në vendin e quajtur "Shkalla e Zezë", që nisi të merrte drejtim nga banesat e fshatit. Në vendngjarje kanë shkuar zjarrfikësit me mjete, të mbështetur nga forca ushtarake dhe forca të pyjores. Zjarri është izoluar, por nuk është shuar plotësisht. Si pasojë e zjarrit u dogj sipërfaqe e madhe me shkurre dhe kullotë.

KORÇË

Në kufirin ndarës mes njësive Lekas dhe Voskopojë, të Bashkisë Korçë ka rënë zjarr masiv në një pyll me pisha të larta. Në terren janë forca të zjarrfikësës dhe forca ushtarake të mbështetura nga helikopteri, dhe operacioni është në vazhdim dhe paraqet vështirësi ndërhyrjeje për shkak të terrenit të thepisur. Në fshatin Leshnje, Barmash, Bashkia Kolonjë ka rënë zjarr në shkurre, pisha dhe ah. Në vendngjarje kanë punuar zjarrfikësit të mbështetur nga forca të pyjores dhe të policisë kufitare duke shuar zjarrin. Si pasojë e zjarrit u dogj rreth 0.3 ha me shkurre, pisha dhe ah.

DETYRIMI

Personi rezident i regjistruar për qëllime tatimore deklaron dhe paguan tatimin e mbajtur në burim, në masën 15% të shumave bruto të pagesave, deri në datën 20 të muajit që pason muajin e pagesës

DIVIDENDET

Për dividendët, deklarimi dhe pagesa e tatimit të mbajtur në burim bëhet brenda datës 20 gusht të çdo viti, pavarësisht nga koha kur do të kryhet pagesa e dividendëve për përfituesit

Si dhe nga kush paguhet tatimi në burim, përjashtimet

Sipas ligjit, subjektet mbajnë tatimin në burim në masën 15% nga pagesa bruto

Tatimi mbi të Ardhurat Personale, në të shumtën e rasteve, paguhet në momentin që kryhen pagesat duke u cilësuar si tatimi në burim. Tatimet sqarojnë se janë rreth 10 pagesa për të cilat TAP vilet në momentin që bëhet pagesa. Kështu çdo punëdhënës, që paguan për punëmarrësin një pagë a shpërblim, mban Tatimin mbi të Ardhurat Personale, dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës. Personat rezidentë në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 15% nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë.

KONKRETISHT:

- 1-Dividendët;
 - 2-Ndarjet e fitimit;
 - 3-Interesat;
 - 4-Pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale;
 - 5-Pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit;
 - 6-Pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues;
 - 7-Pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to;
 - 8-Pagesat për qiratë;
 - 9-Pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, për shfaqjet e tyre;
 - 10-Të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë.
- Paguesi i shumave është i detyruar të mbajë regjistrime për llogaritjen dhe mbajtjen e tatimit në burim për çdo përfitues të ardhurash dhe t'i vërë ato në dispozicion të

organeve tatimore dhe të personit përfitues të të ardhurave, për të cilin është bërë pagesa. Personi rezident i regjistruar për qëllime tatimore, i cili kryen pagesat e parashikuara në nenin 33 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklaron dhe paguan tatimin e mbajtur në burim, në masën 15% të shumave bruto të pagesave, deri në datën 20 të muajit që pason muajin e pagesës. Përjashtim nga ky rregull bën

PAGAT

Janë 10 pagesa për të cilat TAP vilet në momentin që bëhet pagesa. Çdo punëdhënës, që paguan për punëmarrësin një pagë a shpërblim, mban Tatimin mbi të Ardhurat Personale, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës

deklarimi dhe pagesa e tatimit në burim për dividendët, si dhe për faturat e palikuiduara për shpenzimet për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit, të faturuara nga persona të tretë, për të cilat nuk është paguar tatimi në burim, brenda periudhës tatimore nga tatimpaguesi. Për dividendët, deklarimi dhe pagesa e tatimit të mbajtur në burim bëhet brenda datës 20 gusht të çdo viti, pavarësisht nga koha kur do

të kryhet pagesa e dividendëve për përfituesit. Për faturat e palikuiduara për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit, deklarimi dhe pagesa e tatimit të mbajtur duhet të bëhet brenda datës 20 dhjetor të periudhës tatimore, pavarësisht nga koha kur do të kryhet likuidimi i tyre.

TATIMI NË BURIM NUK MBAHET PËR KËTO PAGESA

Personat rezidentë shqip-

tarë, të regjistruar si tatimpagues të tatimit mbi fitimin dhe të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar ose personat e regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël. Dividendët dhe shpërndarjet e tjera të fitimit për pjesëmarrjet që përjashtohen me ligj nga tatimi mbi fitimin të ligjit; Pagesat e bëra personave jorezidentë për shërbimet për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve dhe mallrave.

Detyrimi

21 gusht, afati i fundit për pagesën e dividendit



Tatimet kanë njoftuar se data 21 gusht është afati i fundit për pagimin e dividendit. Sipas njoftimit zyrtar, referuar nenit 33/1, pika 3 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, ju sjellim në vëmendje se çdo person juridik, duhet të deklarojë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore, tatimin mbi dividendin e pagueshëm, brenda datës 21 gusht të vitit 2017. Pavarësisht nga koha kur kryhet pagesa e dividendëve për përfituesit, pagesa e tatimit mbi dividendin është detyrim i pavarur nga fakti nëse është bërë ose jo shpërndarja e tij. Mosrespektimi i këtij afati është i dënueshëm administrativisht, sipas penaltiteve të zbatueshme bazuar në ligjin nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

TREGTIA E JASHTME

INSTAT: Eksportet u rritën 12.9% në vlerë në 7-mujorin 2017

Deficiti tregtar arriti vlerën 192 miliardë lekë, +1.4%

Në shtatë muajt e parë eksportet e mallrave arritën vlerën 158 miliardë lekë, duke u rritur me 12.9%, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 350 miliardë lekë, duke u rritur me 6.3%, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 192 miliardë lekë, duke u rritur me 1.4%, krahasuar me 2016, referon INSTAT. Për periudhën janar-korrik, shitjet e produkteve shqiptare jashtë vendit u rritën me 12.9% me bazë vjetore, duke ngadalësuar ndjeshëm ritmet e rritjes, teksa për 5 mujorin, zgjerimi ishte gati 17% (dhe për 6 mujorin 13.4%), sipas statistikave të publikuara nga INSTAT. Grupi më i madh i eksportuar vijuan të mbeten tekstilet dhe këpucët, që për 7 mujorin u rritën me 8.7%, në 70 miliardë lekë, duke përbërë 44% të totalit të eksporteve. Pësia e këtij grupi është rritur sërish, duke treguar varësinë e eksporteve tona nga shitja e kraut të lirë të fuqisë punëtore, që është edhe avantazhi



kryesor konkurrues i vendit. Në vlerë absolute, rritjen më të lartë të eksporteve ka vijuar ta ketë grupi "Materiale ndërtimi dhe metale", me një zgjerim prej 7 miliardë lekë me bazë vjetore për 7 mujorin (për tekstilet e këpucët rritja për të njëjtën periudhë ishte 5.5 miliardë lekë), apo me 42%. Rigjallërimi i aktivitetit të Kurum (përmes kompanisë Albametal) dhe shtimi i eksporteve të materialeve të ndërtimit (çimentos) rezultojnë arsyeja kryesore e këtij zgjerimi. Grupi "Ushqime, pije dhe duhan" është rritur me 17% në 16.1 miliardë lekë, duke përshpejtuar ritmet, në raport me 6 mujorin.



Akti Normativ, ja si ndryshojnë zërat e buxhetit 2017

Si do të përballohet rritja e pagave, investimet, arbitrazhet dhe pagesa e papunësisë

Ndryshimet në buxhetin 2017, të cilat në pjesën e dërmuese të tyre i dedikohen gjetjes së fondeve për importin e energjisë dhe shuarjes së zjarreve, kanë synuar në tetë ndryshime gjithësej në zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve. Sipas relacionit të Ministrisë së Financave, rialokime brenda zërave të shpenzimeve të buxhetit janë bërë përkatësisht për:

1- Rritjen e huamarrjes neto nga sektori energjetik me 3 miliardë lekë, për të mundësuar përmbushjen e nevojës për energji elektrike deri në fund të 2017. Situata e pritshme hidrike e parashikuar nga KESH. Si rezultat prodhimi i shoqërisë KESH do të jetë në nivelet e parashikuara nga KESH. Në favor të investimeve publike do të kalohet nga buxheti i shtetit një fond në total prej 1 miliard lekësh, i cili do të mund të përdoret, sipas rasteve të caktuara, vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave

2- Rialokimin e shpenzimeve kapitale, nga projektet me ecuri të ngadalte tek ato me ecuri të lartë. Gjithashtu është propozuar kalimi i një fondi në masën 1 miliard lekë si kontigjencë tek projektet e investimeve publike (me financim të brendshëm apo me financim të huaj), bazuar



Faktorët

ENERGJETIKA

Situata e pritshme hidrike e parashikuar për vitin 2017 nuk do të jetë në nivelet e parashikuara nga Korporata Elektroenergjetike. Për rrjedhojë prodhimi nga KESH do të jetë në nivele më të ulta se ç'mendohej

Shpenzimet

Në favor të investimeve publike do të kalohet nga buxheti i shtetit një fond në total prej 1 miliard lekësh, i cili do të mund të përdoret, sipas rasteve të caktuara, vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave



në performancën e tyre për periudhën e mbetur të vitit. Ky fond propozohet të përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

3-Rritjen e zërit "shpenzime personeli" me 300 milionë lekë, si pasojë e akomodimit të politikës së rritjes së pagave dhe ndryshimeve strukturore të disa institucioneve.

4-Reduktimin e shpenzimeve të interesave me 4.1 miliardë lekë, si rezultat i menaxhimit efektiv të borxhit publik.

5-Rritjen e shpenzimeve korrente me 200 milionë lekë për të përballuar kryesisht shpenzime të lidhura me përfaqësimin e Shqipërisë në çështjet e arbitrazhit të Gjykatave ndërkombëtare, për të evituar krijimin e detyrimeve të prapambetura, shpenzimet të lidhura me emergjencat civile,

INSPEKTIMI

Inspektoriati Teknik u vendos 80 mijë euro gjoba subjekteve

Gjatë muajit korrik, Inspektori Shtetëror Teknik dhe Industrial ka gjobitur 50 subjekte të tregtimit me shumicë dhe pakicë të karburanteve dhe të lëndëve djegëse, pajisjeve nën presion dhe instalimeve elektrike. Vlera e gjobave varion nga 50 mijë deri në 1 milion lekë, sipas të shkeljeve të konstatuara, ndërkohë që për disa subjekte është ndaluar ushtrimi i aktivitetit, pasi këta të fundit nuk dispononin dokumentacionin e nevojshëm. Ndër subjektet e gjobitura, përveç pikave të karburantit, ka edhe restorante apo hotele, ndërkohë që vlera totale e gjobave të vëna kap shifrën e 10.7 milionë lekëve.

nisur dhe nga situata aktuale problematike e lidhur me temperaturat e larta dhe zjarret në masive pyjore të vendit.

5-Reduktimin e shpenzimeve për fondin e sigurimeve shoqërore të ISSH-së në masën 600 milionë lekë, duke u bazuar

në realizimin faktit të 6-mujorit të parë të vitit 2017.

6-Reduktimin me 200 milionë lekë të pagesë së papunësisë, nisur nga niveli i ulët i realizimit në 6 mujorin e parë.

7-Shtimin me 1.2 miliardë lekë të Fondit rezervë të Këshillit të Ministrave, duke konsideruar realizimin faktik tij në fund të 6-mujorit, si pasojë e përdorimit të tij për arsye të parashikuara që kanë karakterizuar gjysmën e parë të këtij viti dhe pritshmëritë e përdorimit të tij për në gjysmën e dytë të vitit. Fondi prej 1 miliardë leke parashikohet të përdoret vetëm për emergjencat që lidhen me faktorë natyrore.

8-Shtimin me 500 milionë lekë të fondit të shpronësimeve, që është një nga elementët më të rëndësishëm në progresin e projekteve të infrastrukturës publike.



INDUSTRI/ INVESTIMET KINEZE RRITEN AFRO 9 HERË MË 2016

Geo-Jade, partner kinez në industrinë shqiptare të naftës

Investimet kineze në Shqipëri janë rritur ndjeshëm, nga 87 milionë dollarë në vitin 2015, në 760 milionë dollarë në fund të vitit 2016. Rritja e investimeve kineze vjen pas bërjes së kontratës koncesionare të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës nga China Everbright Limited dhe të kompanisë Bankers Petroleum nga Geo-Jade. Kompania kanadeze, që prej vitit 2004, ka të drejtën për të operuar në Patos-Marinëz, fusha më e madhe naftëmbajtëse në tokë në Europën kontinentale. Volumi i naftës së prodhuar në vend arrin në rreth 1.2 milionë ton. Kompania kineze e kërkimit dhe zhvillimit të naftës



dhe gazit Geo-Jade Petroleum është një sipërmarrje në zhvillim të shpejtë. Ajo ka avantazhe të dukshme profesionale në teknologji, në menaxhim dhe në network-un e biznesit që ka.

Menaxheri i Bankers Petroleum Albania, Zhang Guanqing thotë se, pas bërjes së kompanisë, Geo-Jade ka importuar nga Kina teknologji për të nxjerrjen e naftës së rëndë, si dhe pajisje e makineri të tjera me kosto të ulët duke reduktuar ndjeshëm koston e nxjerrjes së naftës. Aktualisht kompania po ndërmerr operacione për të zhvilluar eksplorime për hapjen e puseve të reja dhe ndërkohë po vlerëson

edhe potencialet e puseve ekzistuese. Përfaqësuesi tjetër i kompanisë, Kastriot Muskaj thotë se punonjësit shqiptarë të kompanisë janë besimplotë për investitorët kinezë. "Shoh përshirjen e specialistëve kinezë, integrimin e tyre të menjëhershëm dhe puna që po bëjnë për të mësuar më shumë rreth fushës, duke ofruar eksperiencën e tyre vlefshme, që ndërthuret me atë kanadeze e shqiptare. Fusha naftëmbajtëse e Patos-Marinëz do të shndërrohet në një nga asetet më të mira të naftës në Europën Lindore, jo vetëm në Shqipëri dhe Ballkan", thotë Muskaj.

7-mujori, rritje 6.5 % e të ardhurave buxhetore

Investimet në vitin elektoral rriten me 46% ndaj 2016-ës, bashkitë marrin 31 për qind më shumë fonde

Administrata e financave publike ka arritur të ruajë një performancë të mirë edhe gjatë muajit korrik të këtij viti, duke siguruar rritje të të ardhurave si shtatëmuor, ndërkohë që shpenzimet buxhetore janë rritur me një ritëm dyfish më të lartë, krahasuar me një vit më parë në të njëjtën periudhë. Kjo ishte e pritshme për një vit elektoral dhe siç ka ngjarë vazhdimisht me financat publike në situata të tilla. Në përgjithësi, vihet re se ende është ruajtur suficitit buxhetor, por ky është reduktuar shumë ndaj rezultatit të një viti më parë, si dhe të viteve të tjera jo-elektorale. Por, me përjashtim të tatimit mbi të ardhurat personale, që rezultojnë të ketë sjellje në arkën e shtetit më pak lekë se një vit më parë, gati të gjitha zërat e tjerë kanë rezultuar me rritje.

TË ARDHURAT

Në total shifra e të ardhurave buxhetore si 7-mujor ka qenë 248.4 miliardë lekë, nga 233.2 miliardë lekë një vit më parë. Kjo do të thotë se rritja ka qenë në masën 6.5 për qind tek të ardhurat. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar ka sjellë në arkë 5.7 për qind më shumë të ardhura, duke kaluar nga niveli i 74.1 miliardë lekëve në fund të muajit korrik 2016, në 78.3 miliardë lekë në fund të muajit të shtatë të vitit në

vazhdim. Një rezultat edhe më të lartë ka shënuar tatimi mbi fitimin, nga i cili janë re-alkizuar të hyra financiare në masën 19.3 miliardë lekë, nga 18.1 miliardë lekë një vit më parë, me një rritje prej 6.6 për qindësh. Sa u përket akcizave, këtu performance është edhe

më e lartë: 8.6 për qind rritje, duke kaluar nga 23.4 miliardë lekë, në 25.4 miliardë. Ndërkohë, i vetmi zë me peshë në të ardhurat fiskale që rezultojnë me performancë negative ndaj një viti më parë është ai i tatimit mbi të ardhurat personale, ku përfshihen pagat

e punonjësve. Duket se rritja e pagave në administratën publike, apo rritja e pagës minimale në shkallë vendi, nuk kanë sjellë rezultatin e pritshëm, ose fjala është për një rritje të evazionit në këtë drejtim. Pushteti vendor arriti të kapë një rritje në masën

31.5 për qind të të ardhurave të veta fiskale, ndërkohë që shifra pozitive shënojnë edhe kontributet e mbledhura për sigurimet shoqërore (+9.2%) dhe për ato shëndetësore (+7.8%).

SHPENZIMET

“Shpërthimin” e vërtetë zërat buxhetorë nuk e kanë arritur në këtë periudhë në sektorin e të ardhurave, por në shpenzimet. Ndërkohë që shpenzimet në total kanë qenë 14.3 për qind më të larta se një vit më parë si 7-mujor, janë shumë herë më të larta ato që janë kryer në fushën e shpenzimeve kapitale. Shifra e investimeve është 46.2 për qind më e lartë se një vit më parë, dukshëm në mbështetje të projekteve të investimeve me fonde publike, të cilat janë lënë shpesh pas dore në vitet e shkuara, për të arritur stabilizimin e parametrave makroekonomikë, të dëmtuara rëndë nga huamarrja e lartë e qeverisë së kaluar, që rriti shpejt dhe shumë borxhin publik. Si zakonisht, tundimi për të prerë shiritat investimesh edhe këtë herë ishte i fortë për qeverinë Rama, e cila, megjithë përpjekjet e viteve të fundit për të vënë nën kontroll shifrat e borxhit, këtë herë, duke ruajtur gjithsesi suficitin në buxhet, e pakësoi atë 6.4 herë ndaj vitit të kaluar. Kështu, nga 18.4 miliardë lekë surplus në korrik të vitit 2016, këtë vit shifra zbriti në 2.9 miliardë lekë.

REALIZIMI I ZERAVE KRYESORE TE BUXHETIT TE SHTETIT PER PERIUDHEN JANAR-KORRIK I KRAHASUAR (në miliardë lekë)

ZËRI	VITI 2016	VITI 2017	NDRYSHIMI
TË ARDHURAT			
Të ardhurat total	233.2	248.4	+6.5%
TVSH	74.1	78.3	+5.7%
Tatimfitimi	18.1	19.3	+6.6%
Akciza	23.4	25.4	+8.6%
Tatimi mbi të ardhurat personale	19	18.6	-2.1%
Pushteti vendor	9.2	12.1	+31.5%
Sigurime shoqërore	39.1	42.7	+9.2%
Sigurime shëndetësore	6.4	6.9	+7.8%
SHPENZIMET			
Shpenzimet total	214.8	245.5	+14.3%
Investimet	19.9	29.1	46.2%
DEFICIT BUXHETOR			
Suficit	+18.4	2.9	-6.4 herë

Administrata

Në buxhetin e ri parashikohet rritjen e zërit “shpenzime personeli” me 300 milionë lekë, si pasojë e hyrjes në fuqi të rritjes së pagave dhe ndryshimeve strukturore të disa institucioneve, pa ndryshim personeli



LETRAT ME VLERË/ NGA 45 MLN €, U MBLODHËN 39.6 MLN

Qeveria shet obligacione 2-vjeçare në euro, interesi 0.8% në vit

Qeveria shqiptare zhvilloi dje ankandin për shitjen e obligacioneve 2-vjeçare në euro, që treguan sërish një interes të madh nga tregu për të investuar në këto instrumente. Shuma totale e kërkuar nga pjesëmarrësit në ankandë arriti në 64.6 milionë euro, ndërsa shuma e pranuar nga qeveria shqiptare ishte në vlerën e 39.6 milionë eurove. Me qëllim për të mbajtur disi më të ulët kuponin, Ministria e Financave ka preferuar të marrë një hua disi më të ulët nga shuma e shpallur prej 45 milionë eurosh. Megjithatë, kuponi apo interesi mesatar i obligacioneve ishte

Valuta

Nisur nga një euro më e lirë, në muajin nëntor të vitit 2016 qeveria emtoi një obligacion 2-vjeçar me vlerë 35 milionë euro, ndërsa në janar të 2017 u zhvillua një tjetër ankand me vlerë 50 milionë euro



sërish i favorshëm, në nivelin 0.8%, po aq sa në ankandin e mëparshëm të obligacioneve në euro, që ishte zhvilluar në muajin janar. Edhe ky ankand tregoi se kosto e huamarrjes së qeverisë në euro është ndjeshëm më e ulët krahasuar me atë në lekë. Në ankandin e fundit, obligacionet dyvjeçare në lekë u emetuan me një kupon prej 2.64%, nivel ky mbi tre herë më i lartë. Tregu financiar vijon të ketë likuiditet të lirë në euro, në kushtet e rritjes së depozitave dhe kur kreditimi në monedhën europiane është i dobët. Në përgjithësi, oferta për euro në tregun financiar ngelet e lartë, çka

ka sjellë edhe një zhvlerësim të monedhës europiane në kursin e këmbimit me lekun në nivelet më të ulëta të tetë viteve të fundit. Qeveria shqiptare po e shfrytëzon këtë moment të favorshëm për të siguruar financime me kosto më të ulët, duke i emetuar një pjesë të instrumenteve të borxhit në euro. Ankandet në euro për financimin e borxhit të brendshëm janë bërë një praktikë e zakonshme vitet e fundit. Në muajin nëntor të vitit 2016, qeveria emtoi një obligacion 2-vjeçar me vlerë 35 milionë euro, ndërsa në janar të 2017 u zhvillua një tjetër ankand me vlerë 50 milionë euro.



Hyjnë të lahen në liqen, mbyten dy kushërinj

Shtatë vetë u hodhën nga varka, por nuk mundën ta kapnin, pesë shpëtuan dy të miturit u mbytën

Bilanci i mbytjeve në vendin tonë sa vjen edhe rëndohet nga dita në ditë. Dy fëmijë janë mbytur pasditen e djeshme rreth orës 16:00 në vendin quajtur Grilë, në territorin e Malësisë së Madhe në Liqenin e Shkodrës. Viktimat janë dy kushërinj E. T. 13 vjeç dhe S. T. 15 vjeç, të dy banues në fshatin Gruemirë. Sipas policisë, 7 persona po lundronin në liqen me një varkë të vogël dhe kur kanë arritur në thellësi janë hedhur në ujë për t'u larë. Varkën e ka marrë rrjedha e liqenit, ku për pasojë 5 persona kanë mundur të dalin në breg të liqenit ndërsa dy fëmijët janë mbytur. Trupat e fëmijëve janë nxjerrë nga ujërat e liqenit nga policia me ndihmën e banorëve të fshatit rreth orës 17:45. Që prej ditës së djeshme grupi hetimor po vijon punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

"NUK KAPËM DOT VARKËN"

Lidhur me këtë ngjarje të rëndë, policia e Shkodrës ka shoqëruar të mbijetuarit e kësaj ngjarje. Gjatë marrjes në pyetje ata kanë treguar se kishin dalë me varkë në liqen për tu larë. Pasi kishin lundruar në disa metra në thellësi

ME NOT

Pasi janë futur në ujë, djemtë nuk kanë arritur të kapin më varkën, për shkak se rrymat e liqenit, kanë ndikuar në largimin e shpejtë të mjetit lundrues. Për pasojë 7 të rinjtë janë përpjekur të dalin në breg me not.



TRUPAT

Trupat e fëmijëve janë nxjerrë nga ujërat e liqenit nga policia me ndihmën e banorëve të fshatit rreth orës 17:45. Që prej ditës së djeshme grupi hetimor po vijon punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

të liqenit, kanë vendosur të hidhen në ujë së bashku, duke kërcyer nga varka njëherësh. Mirëpo pasi janë futur në ujë, djemtë nuk kanë arritur të kapin më varkën, për shkak

se rrymat e liqenit, kanë ndikuar në largimin e shpejtë të mjetit lundrues. Për pasojë 7 të rinjtë janë përpjekur të dalin në breg me not, por dy më të vegjlit, kushërinjtë E.T

dhe S.T, kanë humbur jetën, duke u mbytur në liqen. Gjatë muajit të fundit kanë humbur jetën disa turistë, por edhe qytetarë shqiptarë në plazhe në Velipojë, Durrës, Divjakë

dhe në jug të vendit. Para dy ditësh në Divjakë humbi jetën një 12-vjeçar, ndërsa të mërkurën pasdite në Zvërnec u mbyt një 10-vjeçar në Portonovë, në të njëjtin vend ku

para një muaji u mbytën tre persona. Ndërsa në Divjakë edhe në Durrës gjatë muajit Korrik dhe Gusht janë mbytur disa turistë nga Kosova që kishin ardhur për të pushuar në Shqipëri.

MBYTJA NË ZVËRNEC

Një ngjarje e ngjashme ka ndodhur tre ditë më parë në Zvërnec ku një vajzë 10 vjeçe është mbytur në plazhin e Portonovës, duke rritur kështu bilancin tragjik të të mbyturve në plazhet tona. Mësohet se e mitura me inicialet A.H, së bashku me motrën e saj kishin shkuar në plazh të shoqëruar nga mamaja e tyre. Dy vajzat ishin futur për tu larë në det mbi një dyshek uji, ndërsa i ka marrë rryma, në ndihmë të tyre ka shkuar e ëma me inicialet V.H, e cila gjithashtu është marrë nga rryma duke mos mundur ti shpëtojë të dyja të miturat, por vetëm njërin prej tyre. E ëma së bashku me vajzën tjetër, morën ndihmën e parë në spitalin rajonal të Vlorës, dhe ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Që prej ditës së djeshme grupi hetimor ka shkuar në vendngjarje dhe po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes, duke nxjerrë edhe njëherë në pah mungesën e sigurisë në plazhet tona.

LAJME SHKURT



Bie në kontakt me energjinë elektrike, vdes 35-vjeçari

Një 35-vjeçar banues në Bathore, ka gjetur vdekjen, pasi ka rënë në kontakt me energjinë elektrike në fshatin Domje. Viktima është B.K. 35-vjeç, ndërsa në momentin që ka rënë në kontakt me energjinë elektrike ishte duke punuar për studimin dhe matjen e nivelit të ujit. 35-vjeçari ka ndërruar jetë gjatë kohës që po transportohej për në spitalin e Tiranës.

Kërkohej nga Turqia, pranga në Morinë kosovarit

Një shtetas kosovar është arrestuar në pikën kufitare të Morinës ditën e djeshme. Në pranga ka përfunduar Ahmet Fetahi, 42 vjeç, banues në Prishtinë, pasi gjatë kontrollit të ushtruar dokumentacionit, rezultoi se ishte person i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Ankara. Mësohet se i arrestuari, është dënuar nga drejtësia turke me 7 vite burg, për veprën penale të "Falsifikimit të Dokumenteve zyrtare". Burime zyrtare nga policia bëjnë me dije se 42-vjeçari do të ekstradohet në Turqi, aty ku është kryer edhe vepra penale për të cilën është dënuar.



Largohen nga banesa dy adoleshente, nëna denoncon në polici

Policia e Kamzës prej 24 orësh është vendosur në alarm pasi në këtë qytet kanë humbur dy vajza të mitura përkatësisht 14 dhe 17 vjeç. Kallëzimi në polici është bërë nga nëna e tyre 41 vjeçarja H.M e cila denoncon se prej 48 orësh vajzat nuk janë kthyer në shtëpi. Motrat të cilat po kërkohen nga policia janë A.M 14 vjeç dhe H.M 17 vjeç. Kërkime janë kryer në zona të ndryshme të Tiranës dhe lokale të natës, por nga këto kontrolle nuk ka rezultuar të jenë gjetur vajzat.



Ngjarja në Lezhë, godasin me armë një person prangosen dy vëllezër

Një 37 vjeçar është arrestuar nga policia në Lezhë, pasi në bashkëpunim me vëllain e tij ka goditur me armë një 26 vjeçar. Dashamir Lucaj sëbashku me vëllain e tij D.L, 36 vjeç, të dy banues në Tale kanë goditur në kokë për motive të dobëta, me qytën e një arme një të ri 26 vjeçar me inicialet, M.L, ku arma ka bërë shkrepte në ajër, duke shmangur një tragjedi të mundshme. Menjëherë pas ngjarjes policia ka arrestuar autorin e goditjes, Dashamir Lucaj si edhe procedon në gjendje të lirë vëllain e tij. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit" "Kanosje", "Prishje e rendit dhe qetësisë publike", "Dëmtime të tjera me dashje" kryer në bashkëpunim.

Plagosen dy minatorë, njëri në gjendje të rëndë

Dy minatorë janë plagosur brenda minierës në fshatin Cerujë. Minatorët ishin duke punuar në një thellësi rreth 500 metra kur janë aksidentuar dhe kanë marrë plagë në trup. Pas aksidentit ata janë dërguar në spitalin e Burrelit, ndërsa raportohet se njëri prej tyre ndodhet në gjendje të mirë jashtë rrezikut për jetën, ndërsa tjetri është dërguar në Tiranë. Ndërkohë që kanë nisur hetimet për kushtet në të cilat punonin dy minatorët që u plagosën.



Plagoset me armë zjarri një i moshuar në Fushë-Milot



Një person është plagosur me armë zjarri. Sipas policisë i plagosuri është N.K. 63 vjeç banues në Fushë-Milot, ndërsa ndodhet nën kujdesin e mjekëve në spital. I moshuari po merret në pyetje për të zbardhur rrethanat e plagosjes me armë zjarri. Grupi hetimor në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, po vazhdojnë hetimet për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe identifikimin e autorëve.

Festojnë në dasëm por 50 vetë prej tyre shtrohen në spital

Helmohen nga ushqimi dasmorët, drejtorja e Higjenës nis verifikimet

Rreth 50 persona janë helmuar nga ushqimi që kanë konsumuar në një lokal dasme në qytetin e Shijakut. Personat e helmuar kanë shfaqur probleme shëndetësore duke nisur nga pasditja e së hënës, ndërkohë që në repartin infektiv të spitalit rajonal Durrës gjenden të shtruar akoma 12 persona. Pacientët shprehen se kanë qenë në dasmë dhe ushqimi iu është dukur i mirë, por shumë shpejt nisën problemet. "Ishim në dasmë, erdhëm këtu dhe petë. Nuk kuptuam asgjë, darka për mrekulli, pastërtia e lokalit në maksimum vetëm ditën tjetër na dha shqetësim. Kam tre ditën në spital, ndihem më mirë", "Jemi më mirë tani, shkuam në dasmë, hëngrëm në dasmë, u kënaqëm atje, ditën tjetër pastaj, sonte u sëmurëm", "Nuk e dimë çfarë ndodhi, jam me temperaturë akoma, nuk e dimë nëse ka qenë nga ushqimi"-shprehet pacientët.

DËSHMIA E MJEKES

Shefja e repartit infektiv Nadire Jani shprehet se pacientët janë shfaqur me diarre dhe temperaturë të lartë dhe aktualisht situata e tyre është më e mirë. "Pacienti i parë që ka ardhur është paraqitur duke u gdhirë dita e martë. Ka qenë me shqetësime gastrointestinale, pra bark, të



Një gna personat e helmuar

vjella, temperaturë të lartë dhe mbasi ka marrë ndihmën e parë në repartin e urgjencës është paraqitur në spital pasi gjendja nuk është përmirësuar. Këtu është pranuar si intoksikacionolimitar pasi gjatë historisë së marrjes së

sëmundjes, pacienti e referonte vetë se mbas ushqimit në një dasmë ka pasur këto shqetësimet. Në këtë situatë është lajmëruar Drejtorja e Higjenës, pasi kështu bëhet denoncimi për sëmundje që mendohet se janë me ç'rreg-

ullime të alimentacionit dhe që mund të jenë të rrezikshme për pjesën tjetër të popullsisë. Pas dy orësh ka ardhur një çift të cilët kishin qenë në këtë dasmë. Erdhën punonjës të Drejtorisë së Higjenës, morën të dhëna, kanë shkruar edhe në

MOSTRAT

Në lidhje me rastin në fjalë drejtorja e shëndetit publik ka nisur inspektimin e lokalit ku është zhvilluar dasma. Autoritetet shëndetësore kanë kërkuar mostra të ushqimit që kanë konsumuar dasmorët, por nga lokali iu është thënë se nuk kanë më asnjë të tillë. Tashmë pritet përfundimit i analizave toksikologjike për të parë se kush e ka shkaktuar helmimin e ushqimit. Nëse do të vërtetëtohet se helmimi është shkaktuar nga ushqimi, pritet që të merren masa administrative ndaj pronarit të lokalit. Një ditë më parë për këtë çështje ka nisur hetimet edhe policia, e cila ka marrë në pyetje pacientët e paraqitur në spital. Lokali ku është zhvilluar dasma mësohet se është në pronësi të 57-vjeçarit Dh.K. Sipas policisë në dasëm janë helmuar E.J, E.J, Dh.J, T.J, Q.K e B.C, përkatësisht 55, 32, 42, 49, 57, 43 vjeç. Materialet i kaluan Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, për vlerësim.

burim, aty ku ka qenë dasmë, kuzhinieri thotë që nuk ka më mostra të ushqimit. Po të martën pasdite kanë ardhur edhe 9 të tjerë, deri në 12 të natës kemi pasur prurje. Të gjithë kanë qenë me të njëjtat shenja"-shprehet Nadire Jani, shefe e repartit infektiv në spitalin e Durrësit.

NISIN HEHETIMET DHE INSPEKTIMI

Në lidhje me rastin në fjalë drejtorja e shëndetit publik ka nisur inspektimin e lokalit ku është zhvilluar dasma. Autoritetet shëndetësore kanë kërkuar mostra të ushqimit që kanë konsumuar dasmorët, por nga lokali iu është thënë se nuk kanë më asnjë të tillë. Tashmë pritet përfundimit i analizave toksikologjike për të parë se kush e ka shkaktuar helmimin e ushqimit. Nëse do të vërtetëtohet se helmimi është shkaktuar nga ushqimi, pritet që të merren masa administrative ndaj pronarit të lokalit. Një ditë më parë për këtë çështje ka nisur hetimet edhe policia, e cila ka marrë në pyetje pacientët e paraqitur në spital. Lokali ku është zhvilluar dasma mësohet se është në pronësi të 57-vjeçarit Dh.K. Sipas policisë në dasëm janë helmuar E.J, E.J, Dh.J, T.J, Q.K e B.C, përkatësisht 55, 32, 42, 49, 57, 43 vjeç. Materialet i kaluan Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, për vlerësim.

Analizat

Helimi, AKU mbyll restorantin në Shijak




Pas helmimit të 50 dasmorëve në një restorant në Shijak të Durrësit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka bllokuar aktivitetin e subjektit. Restoranti do të qëndrojë i bllokuar deri në daljen e përgjigjeve të analizave të kampioneve, ndërsa masa e pezullimit ishte vendimi për bashkë të AKU dhe Drejtorisë së Shëndetësisë. Rreth 50 persona u helmuan dje nga ushqimi që kanë konsumuar në një lokal dasme në qytetin e Shijakut. ata janë paraqitur në spital me diarre dhe temperaturë të lartë, ndërsa 12 prej tyre ndodhen akoma të shtruar. Pritet përgjigjia e analizave për të saktësuar nëse helmimi është shkaktuar nga ushqimet e konsumuara apo jo.

LAJME SHKURT

"Skifteri" erdhi nga Italia, vodhi kasafortën me 9500 € në Tiranë



Zbardhet skema e grabitjes së kasafortës së biznesit të argjendarisë 2 ditë më parë në Tiranë, ndërsa operacioni i policisë për kapjen e autorëve ka zgjatuar 6 orë. Në këtë grabitje sipas hetimeve autori kryesorë ka qenë Eduart Ngota, i ardhur nga Italia në Tiranë më 14 Gusht. Sapo ka mbërritur në Tiranë Ngota ka vënë në jetë planin e grabitjes duke thirrur në ndihmë dhe dy të njohurit e tij mes tyre Zenel Dama dhe shtetasin në kërkim R.B. Nga hetimet, autorëve u janë sekuestruar tre ora, tre byzlykë floriri, një varëse, një makinë dhe sasia prej 9500 euro, të cilat nuk kanë mundur t'i prishin. Për policinë e Tiranës Ngota është person i njohur pasi nga Italia kanë mbërritur të dhënat se ai ka qenë i dënuar për grabitje dhe dy herë të tjera. Hetimet e komisaritit numër 4 dhe sektorit të krimeve kanë zbuluar se grupi kriminal i tre grabitësve ishte informuar nga pastruesja e biznesit për sendet që ndodheshin në kasafortë dhe vendndodhjen e saj. Pas skicës së vendndodhjes së kasafortës ata e kanë pasur më të lehtë për të ndërhyrë e realizuar vjedhjen orët e para të mëngjesit të 15 gushtit.



Itali, arrestohen 5 shqiptarë "specialist" në vjedhje banesash

Pesë shqiptarë janë vënë në pranga nga policia italiane në Brescia dhe në Milano, pasi kishin realizuar dhjetra vjedhje banesash. Të rinjtë shqiptarët ishin nën vëzhgim prej disa muajsh nga autoritetet italiane, pasi makina e tyre, një Mercedes-Benz, shumë e fuqishme ishte pikasur në disa zona ku ishin kryer vjedhje banesash. Banda e hajdutëve shqiptar është arrestuar pas vëzhgimit të kamerave të sigurisë, ku pamjet e siguruar vërtetëtonin se ishin ata që i kishin kryer vjedhjet. Në disa raste grupi kishte shfrytëzuar mungesën e pronarëve të banesave për të hapur dhe vjedhur kasafortat në disa banesa. Sendet e vjedhura nga kasafortat, u janë sekuestruar të rinjve shqiptar. Pesë të rinjve në momentin e arrestimit u janë gjetur armë dhe municion, si dhe pajisje të ndryshme të cilat i përdorin për të hyrë nëpër shtëpi. Për katër nga të arrestuarit, gjykata e vendit fqinj ka vendosur masën e sigurisë "arrest me burg", ndërsa pjesëtarin e pestë të bandës, e ka lënë të lirë.

Polic privat me diploma false procedohet pronari SHPSF

Punësonte policë privat me diploma false, ndalohet dhe procedohet penalisht administratori i një shoqërie të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Tiranë. Sipas njoftimit të policisë, gjatë kontrollit në zyrat e kësaj SHPSF (Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike), janë gjetur dhe sekuestruar tre diploma gjimnazi false të cilat ishin pranuar nga ky administrator për të punësuar tre roje. Ky aktivitet sipas hetimeve të krimit ekonomik ushtrohet në Paskuqan, ndërsa administratori i ndaluar është shtetasi E.R. Për ngjarjen janë proceduar dhe C.K, E.G dhe A.B të cilët kishin paraqitur me dijeninë e tyre diploma të falsifikuara. Sipas ligjit në fuqi për policitë private asnjë punonjës nuk mund të merret në punë pa pasur diplomën e shkollës së mesme dhe trajnimet profesionale përfshi përdorimin e armës dhe kontrollin e tyre nëse kanë apo jo precedent penal.

OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë agjent marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

PERSONAT E INTERESUAR TË DËRGOJNË CV E TYRE NË ADRESËN:

marketing@shqiptarja.com

TË KETË ARSIM TË LARTË
TË KETË PËRVOJË PUNE
TË JETË I GATSHËM PËR TË PUNUAR NË TERREN

Mashtrori me siguracionin e makinave, hetim 38-vjeçarja

Ndaj një 38-vjeçare, punonjëse në një agjencie të Policës së Sigurimit, ka filluar një procedim penal, pasi akuzohet për "Vjedhje duke shpërdoruar detyrën", "Mashtrim" dhe "Falsifikim i stampave, vulave dhe formularëve". Procedimi ndaj 38-vjeçares ka nisur pasi ka prerë një policë sigurimi për "Sigurimin e Detyrueshëm të Mjeteve", por shuma prej 18.274 lekësh, e cila është paguar për këtë siguracione nuk është hedhur në sistem.

ÇESHTJA E
BALLIST MORINES

NDALIMI

Morina u ndalua para rreth dy muajsh në kufirin mes Malit të Zi dhe Kroacisë, teksa po tentonte që të kalonte për në Itali. Pas verifikimeve rezultoi se ishte në kërkim nga Serbia duke sjellë edhe arrestimin e tij dhe nisjen e proceseve gjyqësore.



EKSTRADIMI

"Ekstradimi në Serbi do të thotë vdekje për Ballistin. Xhevahir Morina shprehet se Serbia është një armik që i ka dhënë provat dhe ekstradimi do të ishte 100% vdekje për autorin e ngritjes së dronit në Beograd në ndeshjen e para tre viteve.

me po të njëjtat argumente, ndërsa vendimi do të apelohej brenda tre ditëve. "Ekstradimi në Serbi do të thotë vdekje për Ballistin. Xhevahir Morina shprehet se Serbia është një armik që i ka dhënë provat dhe ekstradimi do të ishte 100% vdekje për autorin e ngritjes së dronit në Beograd në ndeshjen e para tre viteve.

Gjykata kroate vendos: Ballisti të ekstradohet në shtetin Serb

Flet vëllai i Ismail Morinës: Kemi dy shpresa, apelojmë vendimin



FEDERATA

Ndërsa FSHF pak ditë më parë deklaroi se për çështjen që akuzohet Ballisti, Gjykata e Arbitrazhit Sportiv ka marrë një vendim duke gjobitur Shqipërinë me 100 mijë euro, duke e cilësuar të mbyllur. Ismail Morina u ndalua para rreth dy muajsh në kufirin mes Malit të Zi dhe Kroacisë, teksa po tentonte që të kalonte për në Itali.

NË FOTO:

Balist Morina në sallën e gjyqit

të rreme, pasi është çështje e ndjeshme" deklaroi ai për Report Tv.


AVOKATI: NUK DO TË EKSTRADOHET NË BEOGRAD

Ndërsa avokati i Morinës, Darko Butigan thotë se Ballisti nuk do të ekstradohet dhe dosja e tij do të rishqyrtohet

nga fillimi në Gjykatën e Shkallës së Parë. "Rikthehet nga fillimi çështja e Ismail Ballist Morinës. Do të rishqyrtohet edhe njëherë nga fillimi, ndërkohë që nuk do të ndodhë asnjë ekstradim. Vazhdon beteja ligjore, pa ralelisht edhe procedura e azilit që ka kërkuar Ismail Morina", tha Darko Butigan.

INTERVISTA

Argentinasi Dybala premtion besnikëri për Juventusin



Në të tashmen dhe në të ardhmen e Paulo Dybala, ka vetëm një skuadër, Juventus. Ylli argentinasi në një intervistë të dhënë për gazetën amerikane New York Times, ka përsëritur edhe një herë tjetër, se nuk e mendon aspak largimin nga radhët e kampionëve të Italisë. Gjatë kësaj interviste, 23-vjeçari ka deklaruar se vendimi i drejtuesve për t'i dhënë atij numrin 10 e ka befusuar, por ai ndihet nderuar dhe premtion se do të japë maksimumin e tij për arritjen e objektivave që ka ekipi. Përsa i përket interesimit që ka shfaqur Barcelona dhe humbja në finalen e Champions League ndaj Realit të Madridit, Dybala shprehet se ekipi ku ai luan është në të njëjtin nivel me katalanasit dhe humbja ndaj Realit është si një makth për të që kërkon ta harrojë sa më shpejt. Objektivi Champions, për argentinasin është një ëndërr të cilën beson se shumë shpejt do ta ketë në duart e tij këtë trofe. Një tjetër trofe i humbur ai në finalen e Super Kupës së Italisë është një moment të cilin Dybala kërkon ta lërë pas krahve, zhgënjimi nuk mungon, por skuadra duhet të shohë përpara. Në fund "La Joya" e mbyll intervistën me premtimin se sezoni i ri për Juventusin do të jetë akoma edhe më i mirë se ai që u la pas.

MBROJTESI/ YLBER RAMADANI PO I MAHNIT TË GJITHË ME PARAQITJET E TIJ

Ramadani shkëlqen te Velje, grumbullohet nga U-21



Ylber Ramadani

La Partizanin gjatë kësaj vere për të nisur një aventurë të re te Velje në kategorinë e dytë të futbollit danez. Por edhe pse ka vetëm pak kohë që është bërë pjesë e skuadrës që tashmë drejtohet nga ish trajneri i të Kuqëve, italianii Adolfo Sormani, Ylber Ramadani po i mahnit të gjithë me paraqitjet e tij. Klas, teknikë, forcë dhe vizion për lojën janë këto disa nga cilësitë e mesfushorit shqiptar i cili është shndërruar menjëherë në një titullar të padiskutueshëm te Velje me trajnerin Sormani që i ka dorëzuar

celësat e repartit të ndërmjetëm talentit kuqezi. Objektivi kryesor i Veljes është ngjitja në elitën e futbollit danez dhe deri tani fillimi i kampionatit ka qenë me të vërtetë mbresëlënëse për skuadrën e Ramadanit dhe Sormanit pasi Velje kryeson klasifikimin e kategorisë së dytë me pikë të plota. Në 3 ndeshjet e para Ramadani ka luajtur me minutazh të plotë duke shfaqur një pjesë të mirë të potencialit të tij. Falë formës së mirë që ka treguar me Veljen ish mesfushori i Partizanit është grumbulluar nga trajneri i

kombëtares Shpresa të Shqipërisë për dy sfidat e rradhës kualifikuese që kuqezinjët do ti luajnë në muajin Shtator ndaj Irlandës së Veriut dhe Islandës. Lajmi është konfirmuar nga vetë klubi i Veljes në faqen zyrtare. Shqipëria e 21-vjeçarëve e nisi me një barazim pa gola ndaj Estonisë fushatën kualifikuese për Europianin e vitit 2019. Ramadani deri tani është aktivizuar në 7 takime me kuqezinjët e rinj. Kalimi i 21-vjeçarit nga Partizani te Velje gjatë kësaj vere solli në arkat e klubit të kuq rreth 200 mijë Euro. Supersport

Gjykata e Shkallës së Parë në Dubrovnik ka vendosur ekstradimin e Ismail Morinës në Serbi, duke lënë në fuqi vendimin e herës së parë. Lajmi u konfirmua dje pasdite për Report Tv nga vëllai i Ismail Morinës, Xhevahir Morina në një lidhje telefonike pas vendimit të Gjykatës. Pas kthimit të dosjes nga Gjykata e Lartë për rigjykim në Shkallën e Parë, brenda 6 ditëve sërish Gjykata e Dubrovnikut ka vendosur që shqiptari të ekstradohet, por çështja sërish do të apelohej. Vëllai i Ballistit deklaroi për Report Tv se vendimi do të apelohej, ndërsa mundësia është e madhe që Gjykata e Lartë të rrezojë vendimin e Shkallës së Parë, pasi në vendimin e pak ditëve më parë argumentonte se vendimi i Gjykatës së Dubrovnikut është i paqartë, pasi Beogradi nuk ka sjellë prova bindëse për ekstradimin. Por edhe nëse Gjykata e Lartë do të vendosë që të ekstradohet, fjalën e fundit do të thotë ministri i Drejtësisë së Kroacisë. Ndërsa ende nuk ka marrë përgjigje kërkesa e "Ballistit" për azil politik në Kroaci. Serbia e akuzon për nxitje të urrejtjes mes dy vendeve pas ngritjes së dronit duke lëshuar fletë-arresti me qëllim ekstradimin e tij për ta gjykuar në Beograd. Qeveria shqiptare ka lobuar fuqishëm që Ismail Morina të mos ekstradohet në Serbi, pasi i rrezikohet jeta. Pak ditë më parë ministria shqiptare e Drejtësisë i dërgoi homologes së saj në Zagreb një raport me fakte dhe argumente se përse nuk duhet të ekstradohet Morina në Serbi. Në raport argumentohet se kërkesa e Serbisë për ekstradimin e Morinës është një kërkesë politike, ndërsa Ballistit i rrezikohet jetë nëse ekstradohet. Ndërsa FSHF pak ditë më parë deklaroi se për çështjen që akuzohet Ballisti, Gjykata e Arbitrazhit Sportiv ka marrë një vendim duke gjobitur Shqipërinë me 100 mijë euro, duke e cilësuar të mbyllur. Ismail Morina u ndalua para rreth dy muajsh në kufirin mes Malit të Zi dhe Kroacisë, teksa po tentonte që të kalonte për në Itali. Pas verifikimeve rezultoi se ishte në kërkim nga Serbia duke sjellë edhe arrestimin e tij dhe nisjen e proceseve gjyqësore.

VËLLAI: KEMI DY SHPRESA, APELOJMË VENDIMIN

"Dy shpresat e fundit janë Gjykata e Lartë dhe Ministri i Drejtësisë për të penguar ekstradimin e Ismailit në Serbi". Kështu shprehet Xhevahir Morina, vëllai i Ismail Morinës, për të cilin Gjykata e Dubrovnikut vendosi sërish që të ekstradohet në Serbi. Xhevahir Morina thotë se Gjykata e Shkallës së Parë la në fuqi vendimin

Skënderbeut i shpëton fitorjanga duart në Zagreb

Gabimet e arbitrave dhe mungesa e fatit i hoqën korçarëve mundësinë e një fitoreje



Gabimet e arbitrave dhe mungesa e fatit i hoqën korçarëve mundësinë e një fitoreje të madhe në Kroaci. Edhe pse nuk shiheshin si favoritë korçarët dominuan ndaj Dinamos së Zagrebit brenda në Maksimir, duke u ndëshkuar nga naiviteti i minutave të fundit, por mbi të gjitha edhe nga vendimet jo të drejta të gjyqtarëve të ndeshjes, çka mbeten dhe pengu i vetëm i një mbrëmjeje fantastike, për skuadrën model të futbollit tonë. Ashtu sic pritej trajneri Ilir Daja hedh në fushë skuadrën me rreshtimin 4-3-3 duke i besuar që nga minuta e parë majën e sulmit 23 vjeçarit nga Gambia Ali Soue. Skënderbeu e nis mirë takimin duke treguar dhëmbët apsi në dy minutat e para e mban të mbërthyer në gjysmefushën e vetë Dinamon. Megjithatë rastin e parë e kanë pikërisht kroatët që në të parën dalje në fushën e korçarëve në minutën e 3 rrezikojnë me Hodzic pas një krosimi nga e djathta. Më pas radha është e Fernandez që provon nga distanca. Skënderbeu tregon se tashmë dinamo nuk është më një model për tu ndjekur, pasi diferencat janë mbyllur ndjeshëm. Në minutën e 9 Latifi shënon një gol por që për anësorin është në pozicion të parregullt. Përsëritja tregon se korçarëve i mohohet një gol mëse i rregullt. Goli i anuluar nuk demoralizon formacionin e Ilir Dajës, teksa është radha e një kroati të shfaqet me klasin

e tij në Maksimir. Marko Radas tenton me një goditje dënimi por Livakovic bën mrekullinë. Loja spektakolare vijon për tanët që në minutën e 26 ndëshkohen sërish nga asistenti që sinjalizon një pozicion të paqenë jashtë loje për Soue. Vendasit dominojnë me kontrollin e topit dhe për të synuar portën e Shehit duhet ndonjë ndihmë, si ajo që dhuron Gavzaj me topin e humbur në mesfushë por është Radas që ndal gjuajtjen e Resjak. 3 minuta më vonë Osmani një nga më të mriët në fushë fiton një duel për të nxjerrë përpara skuadrën, me Sabien Lilajn që tenton nga distanca. Në minutën e 32 Enis Gavazaj tregohet i pavëmendshëm për të përfituar nga pasiguria e mbrojtjes vendase. Megjithatë 5 minuta më vonë mesfushori nga Prizreni përmirëson jo vetëm vëmendjen në lojë por edhe kontrollin dhe pasimin e topit, duke nxjerrë Latifin përballë portierit Livakovic. 23 vjeçari nga Prishtina tregohet egoist por fati është me të duke dërguar topin në rrjetë. 0-1, një rezultat mëse i merituar në favor të Skënderbeut që provon të shkojë në dhomat e zhveshjes me një avantazh akoma më të thellë. Nimaga fiton vetëm një goditje nga këndi ndërsa Latifi nuk arrin të mposhtë për të dytën herë Livakovic. Pjesa e dytë nis agresive për ish kampionët e superligës, me Soue që sheh ti anulohet goli përpozicion të parregullt. Kësaj radhe vendimi i asistentit



është i drejtë. Pak sekonda më pas është Dinamo që rrezikon por Shehi tregon se pjesa e dytë do të jetë e tija, duke nisur me pritjen e parë ndaj Hodzic. Në të 50 është Fernandez që provon me kokë pas një krosimi nga e djathta, teksa 4 minuta më vonë i njëjti futbollist nuk është në vendin e duhur në momentin e duhur. Prej shumë minutash vendasit luajnë në të djathtë, ku Mici has vështirësi të lënë i vetëm nga Latifi. Dinamo është më agresive dhe mbetet prezente në sulm me Hodzic pikë referimi. Në të 55 është përkishtë boshnjaku që me stopimin e topit

Ndeshja Skënderbeu tregon se tashmë dinamo nuk është më një model për tu ndjekur, pasi diferencat janë mbyllur ndjeshëm.

nxjerr jashtë loje Gojak. më vonë është Doumbia që fton Fernandez por goditja e tij devijohet nga Pavlicic që luan rolin e një mbrojtësi. Iniciativa është e vendasve me korçarët që synojnë të mbrojnë rezultatin pa arritur të jenë agresiv në sulm. Megjithatë në minutën e 72 është James që nuk arrin të japë si duhet pasimin e fundit, teksa disa sekonda më vonë në një kundërsulm 3 kundër 3 është Latifi që nuk arrin të finalizojë. 14 minuta nga fundi vendasit tregohen zemërmirë, pasi Doumbia dhe Gojak nuk kuptohen me njëri tjetrin për të gjuajtur portën e Shehit. Minutat kalojnë dhe presioni rritet, teksa veterani Orges Shehi tregon gjithë klasin e tij. Në të 80 ndal Hodzic pas një goditjeje dënimi, por 4 minuta më vonë 40 vjeçari tregohet monumental duke i mohuar një gol të sigurtë kilenit Henrikes. Një minutë nga fundi i lojës Latifi i jep mundësinë e kundërsulmit James por dueli i shpejtësisë fitohet nga portieri Livakovic. 5 minuta shtesë me kroatët që hidhen përpara të dëshpëruar. Megjithatë në minutën e 94 janë korçarët që bëjnë dhuratën duke i lejuar golin e barazimit. Henrikez që pa të ndalej nga një super Shehi kishte nevojë për fatin që të shënonte golin e barazimit. 1-1 na Maksimir, një rezultat i mirë për Skënderbeun por mbi të gjitha një lojë fantastike, ndaj skuadrës model në rajon. Bileta për në fazën e grupeve të Europa League do të vendoset në Elbasan Arena javën e ardhshme.

TEKNOLOGJIA

Seria A do të nisë sezonin e ri me sistemin VAR



Ndryshe nga sezonet e kaluara të futbollit italian i riu, vjen më një risi

VAR i vjen në ndihmë kampionatit italian. Më datë 19 Gusht do të celë siparin Seria A, ku padiskutim emocionet dhe spektakli nuk do të mungojë. Ndryshe nga sezonet e kaluara, sezoni i ri

i futbollit italian, vjen më një risi. Video Asistent Refere, do të shoqërojë përgjatë gjithë kampionatit skuadrat në përballjet midis tyre. Por si do të funksionojë VAR? Arbitri kryesorë i takimit do të jetë i asistuar nga dy ndihmës të tjerë, të cilët do të qëndrojnë përballë ekranit për të analizuar momentet e dyshimita dhe së bashku me gjyqtarin do të marrin një vendim. Analizimin e situatave asistentët mund ta ndërmarin dhe me vullnetin e tyre, pa pasur nevojën e një kërkesë nga ana e kryesorit dhe më pas ta njoftojë atë. Ky i fundit

në momentet kur ka dilema brenda vetes, për akordimin e një goditje dënimi, kartoni të verdhë të kuq apo dhënie e 11 metërshi, mund të afrohet pranë ekranit dhe të analizojë situatën dhe më pas të ndërmarrë një veprim. Përdorimi i teknologjisë në futboll është ende në hapat e para dhe askush nuk mund ta përcaktojë se sa efikas do të jetë. Gjithsesi në një kampionat si Seria A, ku polemikat në lidhje me vendimet e gjyqtarëve nuk mungojnë thuhet në pjesën më të madhe të takimeve dhe ndoshta VAR do të sjell një lloj reduktimi.

DISFATA

Milani "tenis" me Shkëndijën, e mposht 6-0

Pavarësisht tifozëve të shumtë loja foli tërësisht për ekipin e Montelës

Shpresat e Shkëndijës për të surprizuar Milanin në play off-in e Europa League u shuan që në ndeshjen e parë, duke u mposhtur me rezultatin 6-0 në San Siro. Skuadra nga Tetova u detyrua të shkojë në pushim me disavantazhin e 3 golave ndaj ekipit italian



në një ndeshje ku favoriti nuk diskutohej, por miqtë shpresonin të linin shenjë. Pjesa e dytë ka qenë një kopje e fraksionit të parë, ku kuqezinjët italianë kanë dominuar me lojë duke shënuar sërish 3 gola edhe në 45 minutat e dyta. Pavarësisht mijëra shqiptarëve në stadium që udhëtuan për të parë përballjen historike mes dy ekipeve me simbolet kuqezin, loja foli tërësisht për ekipin e Montelës. Andre Silva dhe Montolivo ishin autorët e 4 prej gjashtë golave të sfidës, ndërsa dy të tjerët u shënuan nga Borini dhe Antonelli. Abdurrahimi dhe Hasani tentuan të ndryshojnë diçka, por futbollistët e Shkëndijës u sfumuan para portës së Donarumës.



Në librin e tij “Prapaskenat kobzeza të Enver Hoxhës”, botim i vitit 2008, gjeneral major Ernest Jakova i bën një skaner gjithë veprimtarisë kriminale të diktatorit Enver Hoxha si gjatë viteve të luftës dhe më pas, me instalimin prej tij të një prej diktaturave më të ashpra. Për periudhën e pasluftës autori ndalet kryesisht e analizon gjendjen në ushtri dhe prapaskenat në Ministrinë e Mbrojtjes. Libri i tij, si një dëshmitar i afërt në shumë ngjarje të prekura vlen si një reference e vlefshme për studiuesit, ndërsa për lexuesit vlen ta rikthejmë vëmendjen tek ky libër sidomos këto ditë kur po artikulohe mendime për një rehabilitim të figurës së Enver Hoxhës. Pasi analizon në tre kapituj të librit shumë teza që trajtojnë prapaskenat tij në drejtimin e Partisë Komuniste, por edhe të Luftës ndaj okupatorëve nazifashistë, e më tej instalimin e metodave më të egra të diktaturës dhe prapaskenave me grupet armiqësore në ushtri, Gjeneral major Ernest Jakova shtron në librin e tij 17 pyetje dhe përgjigje që shumëkush mund ti ketë artikuluar këto 27 vite pas rrëzimit të komunizmit. Dhe në fund të 17 pyetjeve ai sjell një epilog për çështjen që trajton të përmbledhur në 6 konkluzione. Trajtesën me 17 pyetje e përgjigje të autorit dhe 6 konkluzionet e tij mbi “prapaskenat kobzeza të Enver Hoxhës” do i sjellim për lexuesit tanë në tre numra të Gazetës Shqiptarja.com. Në dy numrat paraardhës botuam pjesën e parë dhe të dytë të kësaj analize, ku u trajtuan pothuajse të gjithë pikëpyetjet e ngritura nga autori mbi prapaskenat kriminale të Enver Hoxhës gjatë dhe pas Luftës. Ndërsa pjesa e fundit që botojmë sot, sjell katër pyetjet dhe përgjigjet e fundit ku dallon ajo e mundësisë së rehabilitimit të diktatorit dhe më tej 6 konkluzionet e autorit mbi çështjet e trajtuara prej tij në librin “Prapaskenat kobzeza të Enver Hoxhës”. **Ad.Pe.**

(Vijon nga dje...)

NGA ERNEST JAKOVA
TIRANE

PJESA E TRETË DHE E FUNDIT

14. A MUND TË KETË REHABILITIM PËR ENVER HOXHËN?

Përgjigje: Rehabilitimi parashikohet me ligj. Rehabilitohen ata persona që janë dënuar në bazë të ligjit padrejtësisht. Kështu të gjithë ata që ishin dënuar padrejtësisht nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës, janë rehabilituar individualisht me gjyq dhe në mënyrë kolektive me vendim të Kuvendit Popullor, duke u kthyer atyre edhe dekoratat që u ishin marrë. Për Enver Hoxhën çështja qëndron ndryshe: ai nuk është dënuar padrejtësisht asnjëherë për asgjë nga organet gjyqësore. Pra, Enver Hoxha nuk ka se për çfarë të rehabilitohet. Përkundrazi, krimet dhe tradhtitë e shumta të tij, që janë të dënueshme ligjërisht, kishin mbetur pa u gjykuar e dënuar për një kohë të gjatë. Në këto kushte populli shqiptar (sovrani) pasi e humbi durimin, më 20 shkurt 1992 me të drejtë e dënoi rëndë Enver Hoxhën duke i rrëzuar me neveri përmendoren e tij në Sheshin Skënderbej në Tiranë dhe në të gjitha qytetet e Shqipërisë. Fakti që familja e tij vazhdon të marrë shpërblimin e dekoratave të tij, tregon se

JAKOVA:

PSE NUK MUND TE KETE KURRE REHABILITIM PER ENVER HOXHEN

PJESA E TRETË DHE E FUNDIT E ANALIZES SE GJENERAL MAJOR ERNEST JAKOVES/ Ai nuk është dënuar padrejtësisht asnjëherë, për asgjë, nga organet gjyqësore. Pra, nuk ka se për çfarë të rehabilitohet. Përkundrazi, krimet dhe tradhtitë e shumta të tij, që janë të dënueshme ligjërisht, kishin mbetur pa u gjykuar e dënuar për një kohë të gjatë...

Enver Hoxha akoma nuk është dënuar ligjërisht nga organet kompetente. Përse kjo vonesë apo lënie në harresë e pajustificueshme?

15. SA LLOJE ENVERISTËSH KA?

Përgjigje: Ka dy lloje enveristësh: 1) nga ata që i kanë ardhur në ndihmë Enver Hoxhës për kryerjen e krimeve dhe tradhtive të tij, të cilët mbrojnë Enver Hoxhën për të mbrojtur veten e tyre. 2) Ka edhe nga ata që nuk kanë marrë pjesë në krimet e Enver Hoxhës, por si nostalgjikë besojnë se bashkë me komunizmin

do të rehabilitohet edhe Enver Hoxha. Të dy këto lloje enveristësh njësoj mundohen të mohojnë e të fshehin krimet dhe tradhtitë e Enver Hoxhës dhe ky është një qëndrim negativ që të turpëron. Kurse dënimi dhe demaskimi i krimeve dhe tradhtive të Enver Hoxhës është një qëndrim pozitiv që të nderon.

16. TË DHËNAT ARKIVORE A JANË GJITHMONË TË VËRTETA?

Përgjigje: Jo gjithmonë. Për gjërat me karakter politik arkivat mund t'i ndajmë në

partiake dhe jopartiake. Të parat paraqesin më shumë gënjeshtëri. Të dytat paraqesin më shumë të vërtetën. E vërteta e plotë paraqitet nga historianët jopartiake. Historianët partiake nuk mund të konsiderohen historianë. Pra, të dhënat arkivore për çështjet e Luftës Nacionalçlirimtare dhe të pasluftës, të PPSH, të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit, nuk mund të paraqesin të vërtetën, sepse çështjet paraqiten sipas interesave partiake. Kështu, PPSH prapaskenat e Enver Hoxhës dhe përkrahjen prej saj të interesave jugosllave në Shqipëri i fsheh dhe i mohon. Ashtu si Balli Kombëtar fsheh e mohon marrjen pjesë me forca në operacionet e përbashkëta me gjermanin për asgjësimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ashtu siç fsheh e mohon Legaliteti bashkëpunimin e heshtur me gjermanin për të mos sulmuar njëri-tjetrin. Në rastin konkret janë bërë përpjekje që të dhënat e këtij libri të paraqesin të vërtetën mbasi janë bashkëkohës dhe pjesëmarrës aktivë në ngjarjet dhe e kam vënë veten në rolin e një historiani jopartiake në trajtimin e çështjeve. Sa e kam arritur këtë, do ta thonë lexuesit.

17. PËRSE MEHMET SHEHU DHE BEQIR BALLUKU NDRËPRENË STUDIMET NË AKADEMINË USHTARAKE “VOROSHILOV” TË BS DHE NUK E PËRFUNDUAN ATË?

Përgjigje: Sepse vetë Enver Hoxha ishte pa asnjë lloj arsimit të lartë dhe nuk mund ta lejonte që këta të ngriheshin mbi të si ideologë ushtarakë, kur i tillë duhej të ishte ai vetë. Mehmet Shehu ndërpreu studimet pas gjashtë muajsh, me pretekstin se gjoja do të sulmonte greku. Beqir Balluku ndërpreu studimet pas një viti se gjoja ushtria kishte nevojë për të. Shkollimi i kuadrove të ushtrisë që ishte nevojë e domosdoshme për fuqizimin e ushtrisë dhe rritjen e gatishmërisë luftarake të saj, binte ndesh me interesat personale të Enver Hoxhës si i pashkolluar që ishte. Prandaj ai, kuadrot e larta të ushtrisë, nga frika e madhe, i ka konsideruar gjithnjë kundërshtarë të tij dhe siç është thënë më lart, i ka likuiduar duke i cilësuar armiq dhe shpallur veten shpëtimtar të Shqipërisë.

EPILOGU

1. Enver Hoxha, si udhëheqës i popullit shqiptar gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe pas çlirimit të Shqipërisë, del se ka qenë “kriminel e frikacak” dhe “tradhtar e faqja e zezë”.

I vendosur në postet drejtuese më të larta: kryetar i PKSH (PPSH), Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë dhe kryetar shteti, si më i papërshtatshmi pro jugosllav, me miratimin e Titos dhe të Stalinin, ai ka luajtur në Shqipëri rolin e “kalit të Trojës” dhe atë të “agjentit e të poliagjentit” në shërbim të tyre. Në shërbim të Titos ai ka bërë shumë për t'i hapur rrugën aneksimit të Shqipërisë si republikë e shtatë e Jugosllavisë, e cila nuk u realizua për fajin e vetë Titos. Në shërbim të Stalinin, ai ka vendosur në Shqipëri “diktaturën komuniste”, e cila i ka likuiduar të gjitha “fitoret demokratike” të luftës sonë nacionalçlirimtare.

Në rast se një njeri që vret pas shpine apo me akuza false kuadro të larta të ushtrisë dhe të shtetit për interesat e tij personale, quhet “kriminel”. Enver Hoxha ka plot të tilla, sa del kriminel përbindësh. Pra, krimet kryesore të tij kanë qenë: a) vrasja pas shpine e Mustafa Gjinishit, Qemal Stafes e shumë kuadrove të tjera të larta me kërkesën e Miladin Popoviçit. b) Eliminimi i kuadrove kryesore ushtarake të ushtrisë dy herë: atyre të luftës për t'u rrëmbyer lavdinë e drejtimit të luftës dhe atyre të pasluftës nga frika e madhe imagjinare që e kish kapur si frikacak që ishte. c) Burgosja dhe internimi pa afat i qindra mijëra njerëzve të pafajshëm me gjithë familjet, ku shumë prej tyre gjetën vdekjen. E raste të tjera si këto.

Fakti që familja e tij vazhdon të marrë shpërblimin e dekoratave të tij, tregon se Enver Hoxha akoma nuk është dënuar ligjërisht nga organet kompetente.

Në rast se një njeri i vjen në ndihmë të huajve në dëm të interesave të vendit të vet quhet "tradhtar". Enver Hoxha ka plot të tilla. Pra, tradhtitë kryesore të tij kanë qenë: a) sabotimi i vendimeve të Konferencës së Pezës dhe vrasja pas shpine e Mustafa Gjinishit, në përpjekjet për të bërë të mundur aneksimin e Shqipërisë si republikë e shtatë e Jugosllavisë. b) Vendosja e diktaturës komuniste në Shqipëri, e cila i likuidonte të gjitha fitoret demokratike të Luftës Nacionalçlirimtare madhështore dhe të lavdishme të popullit shqiptar, me të gjitha pasojat negative të saj për popullin shqiptar. Dhe shumë të tjera. Pra, krimet dhe tradhtitë e tij karshi atdheut janë të pleksura midis tyre.

Enver Hoxha pa arsim ushtarak dhe pa përvojë luftar, nuk kishte drejtuar asnjëherë një repart ushtarak në luftim me intelekt mediokër dhe frikacak, paaftësi për të mposhtur frikën, që në rast rreziku ishte fshehur duke lënë ushtrinë pa drejtim dhe veten pa adresë, si Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë ishte krejtësisht formal. Në këto kushte, drejtimi i ushtrisë në luftë ishte bërë nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Spiro Moisiu bashkë me komandantët e korparmatave: Mehmet Shehu, Dali Ndreu, Tuk Jakova, Tahir Kadareja etj., të cilët me aftësi e guxim, trima heronj të vërtetë legjendarë bënë të dështojnë të gjitha operacionet e armikut, çliruan veriun dhe e çuan luftën në fitore deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Ai ishte i paaftë edhe për drejtimin e ekonomisë së vendit. Fliste shumë: "Shkenca", "Shkenca", kur shumica e ndërmarrjeve shtetërore dhe shumica e kooperativave bujqësore dilnin deficit dhe kërkonin financim nga shteti. Ai prishi edhe oborrin e kooperativistëve, që ishte një marrëzi e tij. Arritjet në ekonomi kanë qenë aq të vogla sa ai e la Shqipërinë "vandin më të varfër në Evropë". E vetmja arritje e tij janë prapaskenat.

Armët kryesore të tij kriminale kanë qenë: a) Partia të cilën Enver Hoxha e ka përdorur si "shkopin magjik që bën çudira": "E bëri Partia" dhe Partia ishte e pagabueshme dhe duke e barazuar veten me Partinë dilte dhe ai i pagabueshëm. Dhe, ndërsa Shyqyri Ishmi e të tjerë, para litarit bërtisnin si atdhetarë me shumë krenari: "Rroftë Partia!" dhe "Rroftë Shqipëria!", për Enver Hoxhën partia ishte "loja"! b) Prapaskenat që ai kurdiste, të bazuara në përdorimin e mashtrimit e të dhunës sipas koncepteve të tij kriminale diktatoriale. c) Ligjet e shtetit, duke i bërë të tilla që lehtësonin veprimtarinë e tij kriminale, siç ishte ligji famëkeq i agjitacionit e propagandës.

2. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar, ashtu siç e ka emrin, është vepër madhështore e popullit shqiptar heroik e liridashës, i cili iu përgjigj menjëherë thirrjes së "Konferencës së Pezës pluraliste", duke mbushur me vullnetarë të rinj në vazhdimësi formacionet partizane, mori përsipër dhe e çoi luftën deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë, duke e drejtuar atë me bijtë e tij më të mirë që ishin komandantë brigade, divizioni sulmues dhe korparmate, të cilët drejtuan heroikisht, duke arritur rezultate të larta deri në dështimin e të gjitha operacioneve të

njëpasnjëshme më të rrezikshme të armikut gjatë dimrit 1943-1944, pikërisht gjatë kohës që frikamani Enver Hoxha qëndronte i fshehur në malet e Martaneshit dhe e çuan luftën deri në fitoren përfundimtare, në çlirimin e plotë të Shqipërisë. Pra, lavdia e drejtimit të Luftës Nacionalçlirimtare i përket plotësisht komandantëve të njësisve të ushtrisë, trima e heronj të vërtetë dhe jo frikacakut Enver Hoxha që u fsheh dhe la ushtrinë pa drejtim. Demaskimi i këtij qëndrimi të tij, ngre lart dhe e bën më të dukshëm rolin e madh të popullit shqiptar që e bëri luftën dhe të bijve të tij që e drejtuan atë. Pra, madhështia dhe lavdia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar, e njohur dhe e respektuar nga e gjithë bota, me demaskimin e Enver Hoxhës, ngrihet në një shkallë edhe më të lartë.

3. "Konferenca e Pezës" pluraliste është vepër e patriotit të shquar Mustafa Gjinishi. Ajo, me thirrjen e saj madhështore "Të gjithë në luftë kundër okupatorit fashist italian, pa dallim feje, krahina dhe ideje", i dha hov të madh Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar dhe qëndron madhështore dhe e lavdishme, sa është lufta që ajo frymëzoi. Enver Hoxha e PKSH, pasi shfrytëzuan në fillim hovin e madh që ajo i dha Luftës Nacionalçlirimtare, më pas kaluan në moszbatimin si duhet të vendimeve pluraliste të saj, sepse ato do të pengonin realizimin e interesave jugosllave që kishin për qëllim aneksimin e Shqipërisë si republikë e shtatë e saj, që përbën tradhti të lartë të Enver Hoxhës karshi atdheut.

Për rëndësinë e madhe të saj, Konferenca e Pezës përkujtohet çdo vit më 16 shtator me Pezën e madhe heroike në mënyrë tepër festive. Kjo ditë feste është e mbarë popullit shqiptar

ERNEST JAKOVA PRAPASKENAT KOBZEZA TË ENVER HOXHËS



imtare, nuk ka pasur gjatë gjithë luftës për çlirimin e Shqipërisë, sepse: a) deri në Mbledhjen e Mukjes nuk ka pasur. b) Pas Mbledhjes së Mukjes e deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë, forcat e Ballit Kombëtar kanë marrë pjesë në operacionet e përbashkëta ushtarake me forcat gjermane si bashkëpunëtorë, për asgjësimin e forcave të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me qëllim për të marrë pushtetin. Pra, edhe këtu luftë civile nuk ka pasur.

Ndërsa lufta për likuidimin e forcave nacionaliste të Muharrem Bajraktarit dhe të Gani Kryeziut nga Ushtria Nacionalçlirimtare, në fund të luftës pas bashkëpunimit me ta, në pabesi, ka qenë luftë civile sepse ata po e luftonin okupatorin.

6. Në libër kanë gjetur trajtim demaskues edhe dy prapaskenat mashtruese të Ballit Kombëtar: 1) "S'ka ardhur koha" dhe 2) "Bashkëpunimi me pushtuesin gjerman për të asgjësuar Ushtrinë Nacionalçlirimtare dhe pastaj bashkëpunimi me koalicionin anglo-sovjeta-amerikan për të marrë pushtetin". Të dyja këto ide të Mit'hat Frashërit dhe Ballit Kombëtar, të konsideruara "gjeniale" por, që në fakt ishin "kobzeza" tradhtarë, nuk mashtruan njeri, vetëm veten e tyre dhe si të tilla ato dështuan.

Një rezultat të tillë negativ ka arritur edhe Legaliteti me prapaskenën e tij mashtruese për bashkëpunim në heshtje të fshehtë me pushtuesin gjerman: "Nuk të ngas, mos më nga", që është e njëjta gjë, tradhti ndaj atdheut dhe si e tillë ajo mbetet e pajustifikueshme dhe e paretifikueshme.

I DREJTOHEMI "GJYKATËS SË LARTË":

Gjykata e Lartë e atëhershme në shërbim të diktatorit Enver Hoxha, e bazuar në akuzat e tij të padrejta kundër kadrove kryesore ushtarake të ushtrisë, më 1975-1976, ka gjykuar çështjen me diktatin e tij dhe ka marrë masa tepër të rënda me pushkatim, burgim, internim dhe dëbim me gjithë familje, për të gjithë ata. Por, nga të gjitha të dhënat e mësipërme del se likuidimi i kadrove kryesore të ushtrisë është bërë dhe ka mbetur i pajustifikuar, sepse: a) akuza e "puçit ushtarak", nga hetimet e hetuesisë dhe të Gjykatës së Lartë, nuk u vërtetua sepse nuk kishte. Ai kishte ekzistuar vetëm në fantazinë e Enver Hoxhës. b) Edhe akuza e dytë që u bë pas dështimit të së parës, se kuadrot e ushtrisë kanë qenë kundër Tezave të KM gjithashtu nuk u vërtetua, sepse Tezat e KM ishin të bazuara dhe paraqitnin tërësisht idetë e kadrove kryesore ushtarake të ushtrisë dhe këta nuk mund të ishin kundër ideve të tyre. c) Kjo vërtetonte se Beqir Balluku nuk ka pasur ide të tjera të quajtura nga Enver Hoxha "Tezat e Zeza", kur të tilla ishin "idetë e zeza të bunkerizimit" të Enver Hoxhës dhe ato të pasjes së "dy lloje forcash" të Mehmet Shehut në Plenumin e 12-të të KQ. Kështu, të gjitha masat e marra nga Gjykata e Lartë e atëhershme kundër kadrove kryesore të ushtrisë ishin të pabazuara, të padrejta. Pra e udhës është që Gjykata e Lartë e sotme: 1) të rimarrë në gjykim edhe një herë çështjen, për të anuluar vendimet e padrejta të marra karshi tyre. 2) Të gjykojë siç e kërkon drejtësia veprimet kriminale e tradhtarë të Enver Hoxhës. I takon qeverisë shqiptare, që në bazë të vendimit të Gjykatës së Lartë, të marrë masat e nevojshme për nderimin e tyre si atdhetarë të shquar që ishin dhe për shpërblimin e familjeve të tyre.

4. Populli shqiptar me shumë të drejtë, më 20 shkurt 1992, përmbysi përmendoren e Enver Hoxhës në sheshin "Skënderbej" në Tiranë dhe gjithashtu në të gjitha qytetet e Shqipërisë, si të pamerituara. Për nder të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, e udhës është të ngrihen disa përmendore si vijon:

a) Në sheshin "Skënderbej": të vendosen pranë njëri-tjetrit në grup, monumentet e komandantëve heroikë të njësisve që drejtuan luftën dhe e çuan atë në fitore, në çlirimin e plotë të Shqipërisë: Tuk Jakova, Mehmet Shehu, Dali Ndreu, Tahir Kadareja, Petrit Dume, Bedri Spahiu, Qemal Stafa, Nako Spiro.

Monumenti i secilit nga këta të vendoset edhe në qendrën e rrethit përkatës (sasia dhe emrat e tyre janë të diskutueshëm).

b) Për nder të Konferencës së Pezës, në Pezën e Madhe heroike të ngrihet monumenti i ideatorit dhe realizuesit të saj, patriotit të shquar Mustafa Gjinishi. Ky të ngrihet edhe në qytetin e tij Peqin.

5. "Luftë civile" në Shqipëri midis forcave të Ballit Kombëtar dhe Ushtrisë Nacionalçlir-





Furgoni me të cilin autori përplasi këmbësorët

Autori Driss Oukabir

Të plagosurit në rrugë pak momente pas sulmit

AUTORËSIA**ISIS merr përsiper sulmin në Barcelonë**

I ashtuquajtur shteti islamik ka marrë përsiper përgjegjësinë për sulmin në Barcelonë duke thënë se është kryer nga ushtarët e shtetit islamik. Agjencia e lajmeve e lidhur me ISIS, Amaq publikon marrjen përsiper të sulmit në Spanjë. Grupi nuk ka dhënë as prova dhe as detaje të mëtejshme për të mbështetur këtë pretendim. Një person u arrestua në Barcelonë në lidhje me sulmin ku deri tani janë konfirmuar 13 të vdekur dhe 80 të plagosur.

Xhihadistët godasin në Spanjë, makina lë 13 persona të vdekur

Kanë mbetur të plagosur më se 80 persona, sulm kundër këmbësorëve

**NGJARJA**

Një furgon është përplasur me këmbësorët në një zonë turistike, në atë që policia spanjolle e konsideroi menjëherë si sulm terrorist, në një nga zonat më të populluara nga turistët në vend

Rikthehen aktet terroriste kundër qytetarëve të pambrojtur në Evropë. Të paktën 13 të vdekur dhe dhjetëra të tjerë të plagosur janë regjistruar pasditën e kësaj të enjteje në Barcelonë, kur një furgon është përplasur me këmbësorët në një zonë turistike, në atë që policia spanjolle po e konsideron si sulm terrorist. Dëshmitarë nga vendngjarja kanë publikuar foto dhe video nga momenti i tmerrit, ndërsa atje shkuan automjetet e emergjencës, pas përplasjes së ndodhur në sheshin ikonë "Las Ramblas" të frekuentuar shumë nga turistët. Njerëzve aty pranë iu tha të shmangin zonën, ndërsa shërbimet e emergjencës i janë përgjigjur menjëherë sulmit në kryeqendrën e Katalunjes. Linjat e metrosë u mbyllën menjëherë, sikurse edhe dyqanet përreth zonës, ndërsa këmbësorët vraponin nga të katër anët në kërkim të strehimeve të sigurta, teksa policia zbrakoi me forca të shumta në zonë. Dëshmi nga vendngjarja tregojnë se një furgon u drejtua përmes turmës së këmbësorëve, në momentin që ata kalonin nga njëri trotuar në tjetrin. Policia konfirmoi përplasjen "masive", por dëshmitarët thonë se kanë dëgjuar edhe të shtëna armësh. Gazeta "El País" njofton se drejtuesi i mjetit është larguar në këmbë pasi përplasi dhjetëra këmbësor. Sipas forcave të rendit, një nga autorët ishte Driss Oukabir, maroken, i skeduar më

parë për lidhje me organizata terroriste. Ai është arrestuar. Edhe pse detajet e incidentit nuk janë momentalisht të qarta, përdorimi i automjeteve për të shkakuar panik dhe viktima në vendet e BE-së është përdorur që nga korriku i vitit 2016, në një seri sulmesh terroriste nga militantë islamikë, duke vrarë mbi 100 persona në Nice, Berlin, Londër dhe Stockholm. Javët e fundit, grafitë kërcënuese ndaj turistëve janë parë në Barcelonë, aty ku shkojnë të paktën 11 milionë turistë në vit. Në një video të publikuar nën sloganin "turizmi vret fqinjësinë", disa individë kanë ndaluar një autobus me turistë në Barcelonë, duke shpuar gomat dhe duke vizatuar me spraj nëpër xhamat e tij.

VRITET NJË NGA TË KËRKUARIT

Një nga dy persona e kërkuar nga policia katalanise në lidhje me sulmet e Barcelonës ka vdekur në një shkëmbim zjarri me agentët, kështu raporton televizioni Katalanas TV3, por duke theksuar se nuk është një lajm i konfirmuar nga autoritetet.

POLICIA NDALON NJË TJETËR PERSON TË DYSHUAR

Policia spanjolle ka arrestuar dy persona të dyshuar për përfshirje në sulmin. Një nga këto ishte Driss Oukabir, i cili mendohet se është edhe epersoni që kishte marrë me qira furgonin e përdorur në sulm.

AUTOMJETET

Makinat janë përdorur për të vrarë dhe për të shkakuar panik në vendet e BE-së që nga korriku 2016, në një seri sulmesh terroriste nga militantë islamikë, me 100 viktima në Nice, Berlin, Londër e Stockholm



Shtypi gjerman po e ndjek me vëmendje të veçantë debatin që ndezi në Kosovë e Serbi eseja e botuar nga Aleksandar Vuçiç në mes të korrikut. Presidenti serb kërkonte aty mbi të gjitha një ndryshim të mendësisë për Kosovën në Serbi, ndërsa objekt reflektimi janë edhe tezat e ministrit të Jashtëm serb, Ivica Daçiç. Ka qenë radha e Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi që ta prekte këtë çështje me një shkrim të botuar në "Frankfurter Allgemeine Zeitung" që mban titullin "Treni i fundit për paqen e qëndrueshme". Thaçi vëren se pas gjashtë vitesh negociatash mes Kosovës dhe Serbisë ka pasur vërtet progres, sidomos arritja e marrëveshjes së vitit 2013 për bazat e normalizimit të marrëdhënies, por "nuk është arritur një normalizim i plotë i marrëdhënies". Në artikull, kreu i shtetit të Kosovës kujton se të gjitha këto suksese të pjesëshme janë të rëndësishme, por "nëse do të qëndrojmë tek kjo shpejtësi, shton ai, atëherë marrëdhëniet tona nuk do të jenë normale edhe pas 100 vjetësh". Problemin kryesor, Thaçi e gjen tek fakti që palët ende e shohin njëra-tjetrën si kundërshtarë. Në nuk mund të arrijmë ndonjë ujdi se ku do të shkojmë nëse kemi dallime themelore për atë se nga vijmë, shkruan ai. Si mundësinë e vetme për kapërcimin e mosmarrëveshjeve, ai konsideron një marrëveshje historike mes Kosovës dhe Serbisë, që përfshin njohjen e dyanshme. "Arritja e këtij qëllimi është për të dyja vendet tejet i vështirë dhe kërkon leadership të guximshëm dhe inteligjent. Por, jam i bindur se leadershipi si në Kosovë edhe në Serbi synon që t'u ofrojë qytetarëve të vet atë që presin, pra të gjejnë paqen me njëri-tjetrin. Që kjo të ndodhë duhet të jemi kreativë dhe të gatshëm për të arritur kompromise të tjera", shkruan Thaçi. Në mbyllje të artikullit, Presidenti i Kosovës përmend edhe metaforën e trenit si simbol për të ardhmen. "Ne duhet të tregojmë kujdes që të mos e humbasim trenin e fundit për paqen e qëndrueshme".

ANALIZA

Pas debateve një ditë më parë në Këshillin e Sigurimit mbi Kosovën, "Deutsche Eelle" analizon apelet e Aleksandar Vuçiçit për dialog dhe "pajtim historik me shqiptarët". Disa e brohorasin si vizionar, thotë gjigandi mediatik gjerman, ndërsa kritikët dyshojnë se mos bëhet fjalë për një manovër taktike. Edhe pse posti i kreut të shtetit në Serbi është përgjithësisht simbolik, Vuçiç i ka dhënë atij një dimension tjetër. Prej pesë vjetësh ka në duar frerët e pushtetit si shef i partisë së fuqishme të Përparimit, si zëvendëskryeministër, pastaj si Kryeministër e tani si President i shtetit. Njeriu që në vitet nëntëdhjetë shfaqet si nacionalist i eth-



Thaçi: Ende nuk ka një normalizim mes Serbisë e Kosovës

Vuçiç e çeli diskutimin për raportet me Kosovën pa ofruar një platformë

shëm që sulmonte shqiptarët çdo ditë, kërkon sot ta zgjidhë përfundimisht këtë çështje. Problemi për analistët është se Vuçiç e çeli diskutimin pa ofruar një platformë dhe në Beograd po vrasin mendjen

se si, kur, ku dhe përse do të flitet. Fjalën, sipas Presidentit, duhet ta marrin të gjithë aktorët, edhe Kisha Ortodokse tepër konservatore serbe. Dusan Janjiç, i Forumit të Beogradit për Marrëdhëniet

Ndëretnike, mendon se në thelb thirrja e Vuçiçit për dialog nuk është gjë tjetër veçse një manovër taktike: "Krejtësisht sipas motos: ju pyeta, nuk thatë asgjë, pra unë edhe më tej do të vendos

→ THAÇI

Problemin kryesor, Thaçi e gjen tek fakti që palët ende e shohin njëra-tjetrën si kundërshtarë. Në nuk mund të arrijmë ndonjë ujdi se ku do të shkojmë nëse kemi dallime themelore për atë se nga vijmë, shkruan ai.



→ VUÇIÇ

Prej pesë vjetësh ka në duar frerët e pushtetit si shef i partisë së fuqishme të Përparimit, si zëvendëskryeministër, pastaj si Kryeministër e tani si President i shtetit.

vetë, por përgjegjësinë do ta ndaj me ju". Pavarësinë e ish-provincës serbe Kosovë sot e njohin 111 shtete në të gjithë botën, por jo pesë anëtarë të BE-së dhe fuqitë me të drejtë vetoje në OKB, Rusia dhe Kina. Në Beograd kjo punë shihet në mënyrë të veçantë: pavarësia e Kosovës nuk duhet të njihet, ama realiteti duhet pranuar. Marrëveshja e arritur në vitin 2013 në Bruksel me qeverinë në Prishtinë parashikon kështu integrimin e plotë të Veriut të Kosovës të banuar kryesisht me serbë në Republikën e Kosovës, gjë që shumë vëzhgues e interpretojnë si njohje faktike.

Sondazhi
TIRANE

Bota ka më shumë besim te Vladimir Putin, sesa te Donald Trump. Udhëheqësi i Kremlinit tejkalon me 5 pikë përqindjeje kreun e Shtëpisë së Bardhë sa i përket besueshmërisë, në një sondazh të realizuar nga "Pew Research Center". Sipas të dhënave të sondazhit, nëse mes amerikanëve mbështetja për presidentin e tyre është në nivelin 39.5 për qind, jashtë Shteteve të Bashkuara ajo shembet në 22 për qind. Plot 74 për qind e të intervistuarve nuk kanë aspak besim te numri një i Uashingtonit. Putin, ndërkohë, kap 27 për qind të mbështetjes, që në Rusi arrin në 81 për qind, një nivel tepër i lartë ky. Kohës së Barack Obamës, të cilin e donte e gjithë Europa, duket se i ka ardhur fundi. Në Gjermani, besimi tek



Vladimir Putin dhe Donald Trump

Bota ka më shumë besim te Putin sesa te Trump

Diferenda mes udhëheqësve me 5 pikë përqindjeje


ish-presidenti amerikan ishte 86 për qind, ndërsa tani vetëm 11 për qind përkrahin Trumpin. Situata nuk është më e mirë në Francë, ku kreu amerikan gëzon reputacion të mirë vetëm te 14 për qind e popullsisë. Rezultatet nuk shprehin shumë as në Britaninë e

Madhe e Kanada, ku besimi për Trumpin është në nivelin 22 për qind. Për të gjetur personë që kanë besim te kreu i Shtëpisë së Bardhë duhet të zhvendosemi në pjesë të tjera të botës, si në Indi apo Nigeri, ku mbështetja është respektivisht 40 dhe 58 për qind. Në 37 vendet ku është

realizuar sondazhi, Trump tejkalon Obamën vetëm në Izrael, ku besimi për të arrin në 56 për qind, si dhe në Rusi me 53 për qind kundrejt 11 përqindëshit të përkrahjes që kishte Obama. Nivelin më të ulët të aprovimit, Trump e prek në Iran e Meksikë, ku 76 për qind janë kundër tij.

VENEZUELË

Nuk ka ushqime, grabiten kafshët e kopshit zoologjik



Kriza e bukës në Venezuelë ka mbërritur në një pikë të tillë kritike, sa autoritetet mendojnë që grabitja e disa kafshëve nga një Kopsht Zoologjik në perëndim të vendit është bërë për t'herjet dhe ngrënien e tyre. Shkurtimi i racioneve të ushqimit në vend tashmë është kronik. "Efektivë të policisë kombëtare po kryejnë verifikime në Kopshtin Zoologjik ku janë vjedhur dy kafshë. Ne mendojmë se ato janë grabitur për t'u ngrënë", tha Luis Morales, koordinator sigurie. Kolapsi kaotik i modelit ekonomik socialist në Venezuelë ka gjeneruar një mangësi akute të artikujve ushqimorë në tregje, që ka detyruar me mijëra vetë të kërkojnë ushqim ku të mundën, duke mos përjashtuar as koshat e mbeturinave. Presidenti Nicolas Maduro fajëson protestat e opozitës për situatën e krijuar, me pretendimin se ngërçi buron nga bllokimi i rrugëve e autostradave, ndërsa gishtin e fajit e drejton edhe nga ajo që e konsideron si luftë ekonomike të ndërmarrë prej kundërshtarëve të tij, me ndihmën e Uashingtonit. Drejtuesi i Kopshtit Zoologjik të kthyer në skenën e vjedhjeve të bujshme, Leonardo Nunez kujton megjithatë se grabitjet e javëve të fundit kanë prekur 10 specie të ndryshme, përfshirë një buall të bërë copash, gjë që e shtyn të besojë se e gjithë kjo lojë është orkestruar nga trafikantë, që synojnë t'i marrin kafshët e t'i shesin. Mes gjetarëve të grabitur janë edhe dy tapirë, një specie kjo e rrezikuar nga zhdukja.

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Filmi i ri shqiptaro-britanik me regji të Fatmir Koçi "Elvis Walks Home" (në shqip "Elvis kthehet në shtëpi") pasi përfundoi xhirimet një vit më parë po bëhet pjesë e prezantimit në festivale të rëndësishme ndërkombëtare. Filmi sjell në vëmendje fatin e disa fëmijëve jetimë, të cilët nga luftërat ballkanike në vitin 1999 mbetën në rrugë. Një ditë, ata takohen me një imitues të Elvis Presley-t, i ardhur në Ballkan për të argëtuat trupat britanike. Asnjë nuk e di origjinën e vërtetë të tij. Është një shqiptar që ka emigruar dikur në Londër, dhe përpigjet ta harrojë nga ka ardhur. Një pjesë e aktorëve janë fëmijë. 13-vjeçari Samuel Vargu interpreton Ukën.

AKTORËT

"Roli im në film, ka qenë dikush që besonte, si fillim kur Dritani ishte vetëm unë edhe Viviani i besuam atij, të tjerët të gjithë donin ta vrisnin", u shpreh Samueli. Ndërsa Klaus Laçi tregon për historinë e transformimit të tij në një personazh me prirje kriminale. "Roli ka qenë të mblledhë një grup fëmijësh dhe ngaqë është më i shkathët nga të tjerët, bëhet lider dhe atë e ka ndryshuar lufta të jetë i egër, se nuk mund të jesh ndryshe në kohë lufte. Ka qenë pak e vështirë të ndryshoja në karakter, por u mësova, sa më shumë kohë të investosh në një rol, aq më shumë arrin ta realizosh atë", u shpreh Klaus Laçi.

FINANCIMI

Me 25 milionë lekë të financuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë në Shqipëri dhe një pjesë nga programi i Mediave të Evropës Krijuese dhe Këshillit të Arteve të Uellsit, filmi në total ka kushtuar plot 420 mijë euro, pohon regjisori Fatmir Koçi. "Qendra e Filmit ka investuar 250 milion lekë të vjetra, pjesën më të madhe ata e kanë investuar në skenar dhe skenari për tu realizuar në Londër ka shkuar 42 mijë pound. Ata kanë paguar për muzikën dhe një pjesë të post produksionit. Në total filmi është 420 mijë euro", u shpreh regjisori i filmit, Fatmir Koçi. Pjesa më e madhe e skenarit mban emrin e autoreve angleze Jonathan Preece, por regjisori Fatmir Koçi thotë se ka bërë ndërhyrje të thella në skenar. Dritan Kastrati, i njohur për aktivitetin e tij artistik në teatrot e Londrës dhe produksionet televizive ka rolin kryesor në filmin "Elvis kthehet në shtëpi". Në këtë film rolet e tjera regjisori Koçi ia ka besuar aktorëve Amos Zaharia, Romir Zalla, Erand Hoxha, Sara Kapo, Vivian Biagioni-it, e të tjerët.



Ballkani dhe fëmijët në filmin shqiptaro-britanik

Regjisori Fatmir Koçi: "Elvis kthehet në shtëpi" kushtoi 420 mijë euro



Regjisori Fatmir Koçi pohon më tej se "Ngjarjet zhvillohen në luftërat në Ballkan në 1999, por ky nuk do të jetë një film lufte. Është fati i disa fëmijëve, me një imitues të Elvis Presley-t që zbrit në Ballkan për të argëtuat trupat britanike. Ai takohet me këta fëmijë, që kanë mbetur në rrugëve dhe kanë mbetur jetimë nga lufta". Më tej Koçi shton se pjesa më e madhe e filmit që vjen me skenar të Jonatan Preece, luhet në anglisht, por ka dhe skena në këtë film që janë në gjuhën shqipe.

HISTORIA E FILMIT

Elvis Walks Home u xhiruan në malet e Shqipërisë Qendrore dhe në Jug në një bazë të vjetër ushtarake. Filmi tregon historinë e Mickey, një shqiptar emigrant i paligjshëm, i cili ka jetuar në Londër dhe ka qenë për një farë kohe pjesë e skenave të

imitimeve Elvis Presley-it. Ai merret një punë nga trupat paqeruajtëse britanike në luftërat e Ballkanit 1999. Kur problemet pasojnë, Mickey (i veshur si Elvis Presley) ikën në drejtim të një zone lufte. Ai është kapur nga një grup i fëmijëve refugjatë që e trajtojnë në mënyrë të pamëshirshme. Për të shpëtuar lëkurën e tij, ai qëndron me dhe u tregon atyre se ai është një mjek i Kombeve të Bashkuara. Fëmijët i vënë një armë në kokën dhe i kërkojnë Mickey-it për t'i marrë edhe ata në kampin e refugjatëve të OKB-së. Kur ata arrijnë në kamp, gjendja është e rënduar mes të fraksioneve ndërluftuese. Për të ndaluar luftimet Mickey vë kitarën e tij dhe këndon si Elvsi, pasi ai ecën në fushën e betejës. Betja vazhdon, por Mickey tani është vetë ai, jo Elvsi.

VIDEO/ BALLKANI DHE FËMIJËT E TIJ NË FILMIN SHQIPTARO-BRITANIK



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Ikin teknikët e PD, dorëzojnë dorëheqjet në Kryeministri
- Prokurori që bleu 2 shtëpi e 3 garazhe me paratë e gruas
- Jakova:Hoxha frikacak, u fsheh nga frika në Martanesh, s'kishte rrethim
- Shijak, helmohen 50 persona në dasmë, 12 shtrohen në spital
- Horoskopi për datën 17 gusht Çfarë parashikojnë yjet për ju sot
- Krimi ekonomik bastis policinë private në Paskuqan
- Një ngjarje e pazakontë, studentja nuk njeh kryeministrin e vendit
- Majlinda Bregu dhe vajza e saj nisin pushimet,të dyja në top formë
- Gjykata e Dubrovnikut vendos: Ballisti të ekstradohet në Serbi
- "Skifteri" erdhi nga Italia, vodhi kasafortën me 9500 € në Tiranë

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Vasili: Nëse votat s'do ishin blerë do kishim dyfishin e rezultatit
- Prokurori që bleu 2 shtëpi e 3 garazhe me paratë e gruas
- Ikin teknikët e PD, dorëzojnë dorëheqjet në Kryeministri
- Sot do të dorëzojnë dorëheqjen ministrat teknikë të PD në qeveri
- Jakova:Hoxha frikacak, u fsheh nga frika në Martanesh, s'kishte rrethim

VIDEOT MË TË KLIKUARA

Ekskluzive/Deputeti me 56 shtëpi, zyra, dyqane e karburant



Zvërnec, u fut për t'u larë në det mbytet 10 vjeçarja në Portonovë

Shuhet Ylli Popa, ja si e kujton ish-kryeministri Aleksandër Meksi




Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZHI I DITES

Shqipëria në flakë, a mendoni se Emergjencat Civile po e përballojnë situatën e zjarreve?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë.



1.592 | 325 274
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 34 KUTI

17x17 crossword grid for 'Fjalëkryqi pa skemë'.

- HORIZONTAL
1. E dashura e Porgy-t
-Safety... në pistën e Formula 1.
-Initiallet e Bardot.
-Eshtë si distinktiv.
2. Eshtë botuesi.
-Eshtë posta elektronike.
-Në krye të kryesisë.
3. Një i mbijetuar në Sodoma.
-Në krye të titullarëve
-Janë kronikat e Ray Bradbury.
4. Në krye të europianëve.
-Kompozoi Mallkimi i Faustit.
5. Një mund të jetë i rrallë.
-Në krye të komunitetit.
-Janë artistë si Tristan Tzara.
6. Rita kngëtare.
-Hapin kraterë kur bien.
-Qendër banimi.
7. Initiallet e Dunaëay aktore.
-Numri i oktetit.
-Skema pa kufij.
-Negativ për shkurt
8. Shafir që qe aktor.
-Mund të jenë rrethanore të tilla.
-... në bronz në një film.
9. Qytet italian.
-Qendër në tour.
-Initiallet e Sand aktore.
-Lejon me një jo.
10. Kufizojnë takimin.
-Eshtë një moment.
-Ekberg e la dolce vita.
-Lunë në Italia.
11. Dieta pa ekstreme.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

Word grid for 'Fjalëkryqi pa skemë' with words like TIMOTHY, BADA, ADAMI, EMIRATE, RDKIR, TIRANA, DORIAN, GRAY, ETERRI, PELEGRINA, ZH, ULE, MUNICIONE, RRRL, MARINETTI, ILP, RAA, LIS, PAA, PAUL, AZ, STAMP, TLM, CA, FES, TER, AAI, MARTIN, SHERRI, PROFETI, OE, HEROIK, IAN, LESH, T, IRIM, AN, SIRIANE.

- Maria Rilke shkrimtar.
-Aq ishin muzat
12. Janë edhe ato të fytyrës.
-Eshtë anës rugës.
VERTIKAL
1. Vrau Kimeran.
2. Bëri portretin e Emile Zola-së.
3. Një pjesë e situatës.
-Derisa janë në fund.
-Initiallet e Prost.
-Fund deti.
4. Initiallet e Taylor aktore.
-Initiallet e Tappert.
-Kështu flet ai që i thotë gjërat siç janë
5. Një motel pa ekstreme.
-Fillojnë metodën.
-E dashura e doktor Zhivagos.
6. Një sport tradicional anglez.
-Lumi në Gjermani.
7. Një simbol lëkurëkuqsh.
-M break për të marrë setin.
8. Gironë aktor.
-Me Venture në një lloj ndërmarrje të përbashkët.
9. Babai adoptues i Ester.
10. Ishin si vandalë.
-Një Tatum që qe pianist.
11. Mund të jenë kokë më kokë të tilla.
12. Nuk qarkullojnë më në Itali.
-Paoli kantautor Italian.
13. Ishin psikiatër të dikurshëm.
14. Mund të bëjnë ace me raketë.
-Banuar pa bar.
15. Ente Operative Tiranë.
-Një brilantinë moderne.
-Mbyllin fushata.
16. Eksteme për merak.
-Një shkollë budiste japoneze
-Më shumë se shumë.
17. Eshtë lloj papagalli
-Lumë në Itali.

FJALËKRYQI SPORTIV

17x17 crossword grid for 'Fjalëkryqi sportiv'.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

Word grid for 'Fjalëkryqi sportiv' with words like KARATI, SET, RO, AL, UTRECHT, BECKENBAUER, GSHALLA, P, SO, NICOLE, SKUADRAT, VO, OLA, BA, STRIKE, OT, MARKO, A, REJA, O, ERA, EE, FRANKRIBERY, L, I, ELISBAKAKAJ.

- HORIZONTAL
2. Gabim pa ekstreme.
5. Hapin seancën.
7. Kufizojnë punimet.
9. Robbins aktor.
10. Janë në qendër.
11. Janë në temë.
12. Janë Bob për të rrëshkitur.
13. Merret me të bukurën.
15. Ben i interpretuar nga Charlton Heston.
16. Alexis te Arsenal.
18. Fillojnë tatëpjetën.
20. Një kërcim në atletikë.
23. Kurora pa zanore
24. Lidh brigje.
25. Mund të ushtrohet nga hooligans.
26. Kalime në ekstreme.
27. Pak amoralitet.
28. Fillojnë nisjen.
29. Pausini këngëtare.
30. Sergio te Real Madrid.
34. Eshtë i lartë ai i kampionit.
35. Personazhi në foto.
43. Tom Hanks.
44. Personazhi në foto.
VERTIKAL
1. Gerulaitis që qe tenist.
3. Janë komunitetet.
4. Skuadra e Erick Thohir
5. Një lojë me games.
6. Sanchez ish-tenist.
7. Një qumsht që... duhet shkudur.
8. Eshtë skuadra bardheblu.
9. Ela e volejbollit.
12. Ylli, ish yll i Partizanit.
13. Initiallet e Cantona.
14. Pound që qe poet.
17. Ndodh në kufij.
18. Një aksion në dyshe
19. Eshtë për medaljen e kampionit.
21. Radha pa cifte.
22. Fillojnë panikun.
26. Eshtë triplikësh nga distanca.
30. Mbyllin një hark.
31. Oerter që n ishte diskut.
32. Eshtë shahu i fundit.
33. Titulli i Alex Ferguson.
36. Fillojnë largimin.
37. Hapin seancën.
38. Boris Karloff.
39. Mbyllin një krah.
40. Në krye të katedrës.
41. Initiallet e Moravia-s.
42. Ekstremet e jetës

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1 9

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

HOROSKOPI

DASHI

Çdo gjë do shkojë më së miri ndërmjet jush dhe atij që keni në krah gjatë kësaj dite, madje do i zgjidhni me shumë qetësi problemet që keni pasur. Nuk do ngurroni as të kërkonit falje nëse e keni pasur ju gabimin. Beqarët duhet ta lënë veten të lirë dhe të mos bëjnë çmenduri për të gjetur princin e kaltër. Në planin financiar duhet të merrni masa.

LUANI

Jeta juaj sentimentale do jetë shumë më e bukur sesa ju e kishit menduar. Do arrini t'i shprehni më lirshëm ndjenjat dhe do jeni gati të përjetoni eksperiencën të reja me partnerin/en. Beqarët duhet të tregohen më të arsyeshëm dhe jo t'i jepen të parit që do iu dalë përpara. Të ardhurat do fillojnë pak nga pak të stabilizohen.

SHIGJETARI

Nëse kohët e fundit e keni neglizhuar partnerin/en tuaj, sot duhet të kujdeseni më tepër për të dhe t'ia plotësoni dëshirat. Ka disa persona të jashtëm që po presin rastin t'ua rrëmbëjnë. Beqarët do kenë një ditë shumë të zakonshme. Në planin financiar situata do vazhdojë të mbetet e njëjtë.

DEMI

Partneri/ja do ketë shumë angazhime gjatë kësaj dite dhe nuk do mund t'iu kushtojë dot aq kohë sa dëshironi. Mundohuni të tregoheni më të kuptueshëm dhe të mos i mbani mëri. Beqarët duhet t'i shprehin pëlqimet dhe jo të mbyllin në vetvete. Në planin financiar mund t'ia lejoni vetes shpenzimet, situata është e qëndrueshme.

VIRGJËRESHA

Do vendosni njëfarë distance me partnerin/en tuaj gjatë kësaj dite dhe ambienti në çift do fillojë të ftohet. Yjet këshillojnë të mos e lëshoni veten dhe t'ia lini kohës gjithçka. Beqarët duhet të tregohen paksa të rezervuar me personat që do takojnë. Financat do mbrohen gjatë gjithë kohës nga planetët.

BRICJAPI

Tregohuni gjithë kohës të disponueshëm për partnerin/en tuaj sot dhe jepini atij ndihmën e duhur nëse do ua kërkojë. Toleranca gjithashtu do ishte një virtyt i çmuar. Beqarët nga ana tjetër mund të fillojnë dashuri pasionante me disa persona që i kanë njohur që në fëmijëri. Me financat duhet të tregoheni shumë të matur.

BINJAKËT

Një klimë e ngrohtë bashkëpunimi do mbizotërojë gjatë gjithë kësaj dite në jetën tuaj në çift. Së bashku me partnerin/en do thurni edhe plane për të ardhmen. Beqarët nga ana tjetër do kenë një ditë plot e përplot me takime interesante. Mendohuni mirë që të bëni zgjedhjen e duhur. Financat do jenë paksa delikate.

PESHORJA

Asgjë nuk do shkojë sipas parashikimeve tuaja gjatë kësaj dite në jetën tuaj në çift, prandaj bëni shumë kujdes me ato që do thoni. Partneri/ja nuk do jetë me humor të mirë dhe do i ngelet qejfi shpejt. Beqarët do kenë prioritete të tjera të cilat nuk lidhen me dashurinë. Situata financiare do jetë shumë shqetësuese dhe problematike.

UJORI

Ditë shumë e paqëndrueshme kjo e sotmja për ata që janë në një lidhje. Nuk do keni një komunikim të mirë me partnerin/en dhe kjo mund të sjellë goxha probleme. Beqarët nuk do e kërkojnë me ngulm princin e kaltër, por në fakt për ta do ndodhë diçka e mrekullueshme dhe e papritur. Financat do përmirësohen ndjeshëm.

GAFORRJA

Do keni konfliktetë shumta me partnerin/en tuaj gjatë kësaj dite dhe nuk do arrini dot të flisni qetësisht me të. Gjithsesi yjet këshillojnë të mos dorëzoheni deri në minutën e fundit. Beqarët do jenë me humor të mirë dhe do tregohen më të hapur ndaj takimeve. Financat do jenë paksa të ndërlikuara, kujdes me shpenzimet.

AKREPI

Duhet me patjetër t'i sqaroni mosmarrëveshjet që keni pasur në jetën tuaj në çift sot dhe të filloni të bëni plane për të ardhmen. Nëse lini gjithçka pas dore do jetë tepër vonë. Për beqarët do jetë ditë e nxehtë dhe e mbushur me emocione. Ëndrrat tuaja do fillojnë të realizohen një nga një. Kujdes me shpenzimet.

PESHQIT

Mërkuri do iu ndihmojë të largoni rutinën nga jeta juaj në çift gjatë kësaj dite. Duhet të shtoni edhe pak dozat e imagjinatës në mënyrë që atmosfera të ngrohet. Beqarët nuk do kenë dashuri me shikim të parë as sot dhe kjo do i zhgënjëjë paksa. Në planin financiar nuk duhet ta humbni optimizmin edhe sikur të përballeni me vështirësi.

PËRGJIGJE

Word grid for 'Përgjigje' with words like SARARA, RITMET, HARAPI, PEHIRI, ENKAPILARET, M, NPARAKALIMET, DRITARET, ME, A, ERITTI, IALIAS, TTA, EMIN, TURNI, IETETI, I, EMER, ATE, AMA, SATI, DATT, MAE, I, AA, AN, TURISTET, R, MILITANTET, DEM.

SHKRONJA E NJËTË PËR NUMËR TË NJËTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

17x17 cryptogram crossword grid.

VENDE UNIKE PËR TË VIZITUAR! THE MOST UNIQUE PLACES TO VISIT!



BUNK'ART 1

- Ekspozita video-muzeale e periudhës së komunizmit në Shqipëri e ndërtuar brenda bunkerit anti-bërthamor të Luftës së Ftohtë

- The video-museum exhibition of Albania's communist era build inside the anti-nuclear bunker of the Cold War



BUNK'ART 2


- Ekspozita e parë video-muzeale e ndërtuar në kujtim të viktimave të terrorit komunist

- The first video-museum exhibition built in memory of the victims of the communist terror



Ku ndodhet BUNK'ART 1?

Rr. Fadil Deliu
(afër teleferikut) - Tiranë



Ku ndodhet BUNK'ART 2?

Rr. Abdi Toptani
(përballë Bashkisë) - Tiranë

www.bunkart.al / info@bunkart.al

Prenotime / Reservations:

+355 (0) 67 20 72 905

